AKADEMIA E TË RINJVE
ALBANIAN YOUNG ACADEMY

Me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë
With the Support of Academy of Sciences of Albania



Konferenca e parë mbarëkombëtare shkencore e kërkuesve të rinj shqiptarë

# Metodologjia dhe kërkimi shkencor: traditë e risi



## Methodology and scientific research: Tradition and innovation

4 dhjetor 2017











# LIBRI I ABSTRAKTEVE

# BOOK OF ABSTRACTS

Konferenca e parë shkencore e

AKADEMISË SË TË RINJVE

**"Metodologjia dhe kërkimi shkencor: traditë dhe risi"**

*Tiranë, 4 dhjetor 2017*

# LIBRI I ABSTRAKTEVE

**Përgatitën për botim:**
Andi Rëmbeci, Teuta Toska, Rigers Bakiu,
Edmond Cane, Belfjore Qose

Me mbështetjen e
Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Akademia e të Rinjve
e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë
Tiranë, 2017

1st Scientific Conference of

ALBANIAN YOUNG ACADEMY

**"Methodology and Scientific Research, tradition and innovation".**

*Tirana, 4 December 2017*

# BOOK OF ABSTRACTS

**Editors:**

Andi Rëmbeci, Teuta Toska, Rigers Bakiu,
Edmond Cane, Belfjore Qose

With the Support
of Academy of Sciences of Albania

Albanian Young Academy
of Academy of Sciences of Albania
Tirana, 2017

# FJALË PËRSHËNDETËSE

Në emër të Akademisë së të Rinjve (AR), kemi kënaqësinë t'ju urojmë mirëseardhjen në konferencën e parë mbarëkombëtare shkencore të kërkuesve të rinj. AR-ja është një organ kolegjial i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, i ngritur në qershor 2017 si një komision i përhershëm novacioni me kërkues të rinj të shkencave shoqërore dhe albanologjike dhe të shkencave natyrore dhe teknike. Konferenca e parë mbarëkombëtare shkencore e kërkuesve të rinj "Metodologjia dhe kërkimi shkencor: traditë dhe risi", organizohet me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Do të zhvillohet në 4 dhjetor 2017, në kuadër të veprimtarive për promovimin e Akademisë së të Rinjve, si organizëm i ri shkencor në Shqipëri.

Në Konferencën II të Përbashkët Shkencore të Procesit të Ballkanit Perëndimor, që u mblodh pranë Akademisë Austriake të Shkencave nga data 22-24 maj 2016, ndër të tjera u rekomandua që "*Sistemet e shkencës dhe të arsimit të lartë në vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të bëjnë përpjekje për të qenë të hapura. Ato lipset të ... ndjekin metoda të reja kërkimore dhe të përdorin koncepte të reja organizative*".

Kërkimi shkencor në Shqipëri ka pësuar një ndryshim të thellë në shumë aspekte. Ndër më të rëndësishmit janë metodat kërkimore të zbatuara dhe metodologjitë e studimit si në shkencat shoqërore, ashtu edhe në ato natyrore e teknike. Një pjesë e kërkimeve ende realizohen me metoda dhe qasje interpretuese tradicionale, edhe pse prirja mbizotëruese është "reformimi" metodologjik. Kjo ka sjellë, në mënyrë të natyrshme, evidentime të fakteve të reja, analiza e qëndrime të tjera shkencore, interpretime të ndryshme, në kërkim të së vërtetës shkencore. "Vërshimi" i lirë i metodave kërkon, më së pari, edhe një diskutim në lidhje me to,

për të qartësuar, përzgjedhur e braktisur metoda të caktuara, që nuk i përgjigjen realitetit të zhvillimit në Shqipëri. Përmes prurjeve shkencore, propozimeve dhe diskutimeve, konferenca synon të çojë përpara debatin shkencor për një çështje kaq gjithëpërfshirëse dhe aktuale për studimin shkencor.

Dëshirojmë, pikësëpari, të falënderojmë Akademinë e Shkencave të Shqipërisë për përkrahjen e pakursyer që ofroi në të gjitha aspektet organizative të kësaj konference. Po ashtu, i shprehim falënderime komitetit organizativ të konferencës, i cili ka punuar me përkujdesje dhe përkushtim për mbarëvajtjen e rregullt të punimeve të konferencës. Mirënjohje i takon, gjithashtu, komisionit shkencor që shqyrtoi me profesionalizëm të gjitha abstraktet dhe ndihmoi në organizimin e seancave. Së fundmi, dëshirojmë të falënderojmë të gjithë studiuesit pjesëmarrës që do t'i japin jetë konferencës me punimet e tyre. Suksesi i konferencës sonë është tani në duart e tyre!

Andi Rëmbeci, Rigers Bakiu
Bashkëkryetarë të Akademisë së të Rinjve

## WELCOME ADDRESS

On behalf of Albanian Young Academy (AYA), we are pleased to welcome you to the first scientific conference of the young researchers. The AYA is collegial body of the Albanian Academy of Sciences, established in June 2017 as a permanent innovation commission, with young researchers of social/human sciences and natural/technical sciences. The first scientific conference of the young researchers entitled "*Methodology and research: tradition and innovation*", has been organized with the support of the Academy of Sciences of Albania. It will be held on 4 December 2017, in the framework of the activities for the promotion of the Albanian Young Academy, as new scientific organization in Albania.

At the Joint Scientific Conference of the Western Balkans Process, hosted by the Austrian Academy of Sciences on 22-24 May 2016, it was recommended that "The Higher Education and Science Systems in the Western Balkan Countries need to strive for openness. It is extremely necessary ... to adopt new scientific methods and to introduce new organizational concepts".

The scientific research in Albania has undergone a deep change in many respects. Among the most important are applied research methods and the methodologies of study, both in social sciences as well as natural or technical sciences. Part of the research is still carried out by using traditional methods of interpretation, while the predominant tendency is the methodological reform. This has naturally brought evidence of new facts, analyses and other scientific attitudes, several interpretations in the search for the real scientific facts. "The free flow" of the methods requires a first discussion related to the methodology in order to clarify, select and give up certain methods, which do not respond to the reality

of the recent developments in Albania. Based on the scientific presentations, proposals and discussions, the conference aims to boost the scientific debate about the holistic and actual issues of the scientific research.

First, we would like to thank the Academy of Science of Albania for the great support in all organizational aspects of this conference. We also express our gratitude to the organizing committee, who has worked with care and dedication for the regular progress of the conference. Thanks also belong to the scientific committee, who professionally reviewed all the abstracts and helped organize the sessions. Last, but not least, we would like to thank all the participating scholars, who will give life to the conference with their research results and interpretations. The success of our conference is now in their hands!

Andi Rembeci and Rigers Bakiu
Co-chairs of Albanian Young Academy

**Organizimi i konferencës**

Andi Rembeci (Universiteti i Tiranës)
Rigers Bakiu (Universiteti Bujqësor i Tiranës)
Teuta Toska (Universiteti "Aleksandër Xhuvani" i Elbasanit)
Ilda Kazani (Universitetit Politeknik i Tiranës)
Valbona Sota (Universiteti i Tiranës)
Edelajda Çepa (Universiteti "Aleksandër Xhuvani" i Elbasanit)
Mikaela Minga (Akademia e Studimeve Albanologjike)
Mentor Beqa (Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës)
Belfjore Qose (Universiteti i Tiranës)
Sokol Çunga (Arkivi Qendror Shtetëror)
Anita Berberi (Akademia e Shkencave e Shqipërisë)
Edmond Cane (Akademia e Shkencave e Shqipërisë)
Thomas Frashëri (Kabineti i Kryeministrit)

**Organization of the Conference**

Andi Rembeci (University of Tirana)
Rigers Bakiu (Agricultural University of Tirana)
Teuta Toska (University "Aleksandër Xhuvani" of Elbasan)
Ilda Kazani (Polytechnic University of Tirana)
Valbona Sota (Universiteti i Tiranës)
Edelajda Çepa (University "Aleksandër Xhuvani" of Elbasan)
Mikaela Minga (Academy of Albanological Studies)
Mentor Beqa (University "Aleksandër Moisiu" of Durrës)
Belfjore Qose (University of Tirana)
Sokol Çunga (State Archives of Albania)
Anita Berberi (Academy of Scienes of Albania)
Edmond Cane (Academy of Scienes of Albania)
Thomas Frashëri (Prime Minister's Office)

# TABELA E PËRMBAJTJES

# CONTENTS

Fjalë përshëndetëse ........ 4
Welcome ........ 6
Organizimi i konferencës ........ 8
Organization of the Conference ........ 8

Aida Dervishi, Hairi Ismaili, Zonje Belaj, Xhuljana Arapaj
Metodat e vlerësimit dhe menaxhimit të diversitetit gjenetik bimor: konsiderata të variacionit gjenetik ndërmjet varieteteve kryesore shqiptare të *Vitis vinifera* L ........ 14
Methods of assessment and management of plant genetic diversity: considerations of genetic variation of the main Albanian *Vitis vinifera* L. varieties ........ 15

Andi Rembeci, Sokol Çunga
Studimet në fushën e paleografisë bizantine dhe pasbizantine në Shqipëri: vlerësime për të shkuarën dhe të tashmen, perspektivat dhe sfidat e së ardhmes ........ 16
The Researches on the Byzantine and Post-Byzantine Paleography in Albania, assessments about past and present, perspectives and future challenges. ........ 17

Ani Bajrami
Teoritë dhe metodat evolucionare në studimin e kulturës: rasti i preferencave për partner seksual afatgjatë ........ 18
Evolutionary theories and methods in studying culture: The case of long-term mate preferences ........ 19

Ardian Muhaj
Inercia metodologjike në historiografinë shqiptare të shekullit XXI. Shkaqe dhe pasoja ........ 20
Methodological inertia in the Albanian historiography of the 21st century. Causes and consequences ........ 21

Arta Xhika
Dy metoda në përqasje: nga shkolla e Romës në ato të Kalabrisë

dhe Palermos ........ 22
Two methods of approach: from Rome schools to those in Calabria and Palermo ........ 23

Belfjore Qose
Sfidat që lidhen me përdorimin e metodologjive të reja në studimin e letërsisë shqipe ........ 24
The challenges of using new methodology in studies on Albanian literature ........ 25

Blerta Avdia
Aplikimi i GIS-it në fushën e turizmit, një risi e kohës ........ 26
Application of GIS in scope of tourism, as new innovation of time .. 27

Brunilda Çuko, Valbona Sota, Efigjeni Kongjika
Metodologjitë *in vitro* që shmangin oksidimin polifenolik në eksplante të ndryshme të mollës (*Malus domestica* L.) ........ 28
*In vitro* methodologies that avoid polyphenolic oxidation in different explants of apple (*Malus domestica* L.) ........ 29

Edelajda Çepa
Metoda të kërkimit shkencor në filologji. Lef Nosi si studiues dhe objekt studimi ........ 30
Methodology of scientific research in Philology - Lef Nosi as a researcher and an object of research ........ 31

Edlira Gugu
Metodologjia e Rexhep Qosjes mes risisë dhe traditës në shkencën letrare shqiptare ........ 32
The methodology of Rexhep Qosja between the inovation and the tradition in Albanian researches on literature ........ 33

Elsa Skënderi-Rakipllari
Qasje metodologjike të gjuhësisë së sotme ........ 34
Methodological approaches in modern linguistics ........ 35

Epidamn Zeqo
Teoria e zgjedhjes racionale – themeli qëllimisht i gabuar i sjelljes i neoliberalizmit? ........ 36
Of Rational Choice Theory - The Purposefully Erroneous Behavioural Foundation of Neoliberalism? ........ 37

Erarba Çiraku
Kërkimi shkencor ndërdisiplinar - domosdoshmëri për kërkuesit e rinj shkencorë ........ 40
Interdisciplinary research a necessity for young researchers ........ 41

Eris Rusi
Kompetencat letrare në letërsinë fantastike shqipe të shek. XX ........ 42
Literary competences in the albanian fantastic literature of the 20th century ........ 43

Ermela Broci
Përdorimi i metodave etnografike në kërkimin shkencor: avantazhe dhe disavantazhe ........ 44
The ethnographic methods as a research approach; advantages and disadvantages ........ 45

Ervin Hoxha, Etleva Hamzaraj
Vlerësimi i marrëdhënies mes parametrave fiziko-kimikë dhe atyre mikrobiologjikë në studimin e cilësisë së ujit në komunat e qarkut Fier ........ 46
Evaluating the relationship between physico-chemical and microbiological parameters in the water quality study in the Fier Region communes ........ 47

Flamur Maloku
Letërsia e burgut përballë faktit dhe fiksionit ........ 48
Prison literature versus fact and fiction ........ 49

Helena Lubonja, Aida Zoto
Studimi i tipareve morfo-sintaksore dhe leksikore të fëmijëve shqip- dhe greqishtfolës, përmes metodave të reja kërkimore (Testi i Përsëritjes së Fjalive dhe Testi Matës i Fjalorit) ........ 48
Study of morphosyntactic and lexical features of Albanian and Greek speaking children through new research methods (Sentence Imitation Test and Word Finding Vocabulary Test) ........ 49

Ilda Kazani, Albana Halili, Elma Zanaj, Aulon Shabani, Majlinda Hylli
Tekstilet inteligjente sjellin së bashku hulumtues të fushave të ndryshme disiplinore ........ 52
Smart textiles bring together multidisciplinary researchers ........ 53

Nereida Malo, Amilda Ballata, Sonila Vito, Dhurata Premti, Majlinda Vasjari, Rozana Troja
Përdorimi i burimeve të hapura të edukimit në shkencën e ushqimit ..... 54
Open educational resources in food science ..... 55

Mentor Beqa
Raporti ndërmjet historisë dhe shkencave sociale: a mund të jetë shpjegimi historik teorikisht neutral? ..... 56
The relationship between History and Social Science: Can historical explanation be theoretically neutral? ..... 57

Mikaela Minga
Etnomuzikologjia dhe kënga urbane në Shqipëri ..... 58
Ethnomusicology and the urban song in Albania ..... 59

Odeta Manahasa
Dija nëpërmjet shikimit, shikimi nëpërmjet dijes ..... 58
Knowing through seeing, seeing through knowing ..... 59

Rigers Bakiu
Metodologjia në projekte të kërkimit shkencor praktik për mbrojtjen e specieve detare në rrezik ..... 60
Methodology for practical research to protect the marine species at risk of extinction ..... 61

Sami Behrami, Fadil Bajraktari
Metodat bashkëkohore hartografike në hulumtimet demografike ..... 62
Contemporary mapping methods in demographic research ..... 63

Sonila Vito, Dhurata Premti, Nereida Malo, Amilda Ballata, Majlinda Vasjari, Rozana Troja
Zbatimi i OER-it gjatë procesit mësimor ..... 64
Implementing OER in teaching ..... 65

Shaniko Allajbeu, Pranvera Lazo, Flora Qarri
Biomonitorimi – një qasje e re për vlerësimin e integruar të shkallës së ndotjes në Shqipëri ..... 68
Biomonitoring a new approach to integrated assessment of the scale of pollution in Albania ..... 67

Teuta Toska
Për metodologjinë e kërkimit shkencor në gjuhësinë shqiptare pas viteve '90 ........ 70
About the methodology of the scientific research in Albanian linguistics after the 1990's ........ 71

Valbona Sota, Efigjeni Kongjika
Optimizimi i metodave të mikroshumimit dhe të konservimit *in vitro* të specieve frutore me rëndësi ekonomike ........ 72
Optimisation of micropropagation and *in vitro* conservation methods of fruit tree species economically important ........ 73

Xhaklina Cani, Ilirjan Malollari, Ismet Beqiraj
Praktika metodologjike për karakterizimin e naftave bruto të vendit tonë dhe zbatime ........ 74
Methodological practice of crude oil characterization in our country and applications ........ 75

**Aida Dervishi[1], Hairi Ismaili[2], Zonje Belaj[1], Xhuljana Arapaj[1]**
[1]*Departmenti i Bioteknologjisë i Universitetit të Tiranës,* [2]*q*eN**dra e resurseve gjenetike e Universitetit Bujqësor të Tiranës**

**Metodat e vlerësimit dhe menaxhimit të diversitetit gjenetik bimor: konsiderata të v*ariacionit gjen*etik ndërmjet varieteteve kryesore shqiptare të Vitis vinifera L**

Njohja e diversitetit gjenetik dhe përhapjes së tij është thelbësor për ruajtjen e këtij diversiteti, si dhe në qartësimin e origjinës dhe evolucionit të specieve bimore me interes. Vlerësimi i diversitetit gjenetik të koleksioneve të resurseve gjenetike ndihmon në menaxhimin dhe përdorimin e frytshëm të gjermoplazmës së ruajtur. Hardhia (*Vitis vinifera* L.) është e përhapur gjerësisht në botë dhe ajo përdoret për prodhimin e verës, rrushit, për konsum në tavolinë dhe për fruta të thata. Ajo kultivohet dhe është e rëndësishme në Shqipëri, ku përdoret kryesisht për prodhimin e verërave cilësore, karakteristike të vendit. Organizata ndërkombëtare si OIV, UPOV dhe IBPGR kanë hartuar e miratuar metodologji të unifikuara të përshkrimit ampelografik të varieteteve të hardhisë. Varietetet e hardhisë janë karakterizuar dhe identifikuar tradicionalisht me anë të këtyre deskriptorëve të miratuar. Duke qenë se kjo metodë vlerësimi bazohet në tipare morfologjike, rezultatet ndikohen nga kushtet mjedisore edhe nga faza e zhvillimit të bimës. Metodat tradicionale u pasuruan me zhvillimin e atyre molekulare, të cilat siguronin një identifikim dhe vlerësim të saktë të diversitetit gjenetik në hardhi, i rëndësishëm ky për menaxhimin efektiv të resurseve gjenetike të saj.

Ky studim ka si qëllim vlerësimin e diversitetit gjenetik të varieteteve kryesore të hardhisë në Shqipëri me anë të metodave ampelografike dhe molekulare, për të analizuar dhe krahasuar nivelin e diversitetit gjenetik dhe informacionin që siguron secila nga metodat e aplikuara. Karakterizimi ampelografik është bazuar në deskriptorët e OIV-së për tipare të gjethes së maturuar, lastarëve, lulesës, bistakut dhe kokrrës së frutës. I njëjti set mostrash u analizuan me metoda molekulare. Disa nga tiparet ampelografike të analizuara, si forma e hapur e majës së lastarit, gjatësia e bishtit të gjethes dhe gjatësia e bistakut rezultuan diferencuese për disa varietete, duke sugjeruar përdorimin e këtyre tipareve për

**Aida Dervishi[1], Hairi Ismaili[2], Zonje Belaj[1], Xhuljana Arapaj[1]**
*[1]Department of Biotechnology of University of Tirana. [2]Genetic Resources Centre of University of Agriculture of Tirana*

## Methods of assessment and management of plant genetic diversity: considerations of genetic variation of the main Albanian *Vitis vinifera* L. varieties

The knowledge of genetic diversity and its distribution is essential for its conservation and use. This information serves the purpose of defining what to conserve and will improve our understanding of the origin and evolution of plant species of interest. The understanding of the genetic diversity that is present in collections is equally important in view of the better management of the conserved germplasm.

A very important horticultural crop widely used for the production of wine, table grapes and dried fruits, is Grapevine (*Vitis vinifera* L.), which is also widely cultivated. It is important in Albania where it is used mainly for the production of very good quality wines. The OIV, UPOV and the IBPGR have agreed upon the establishment of a common methodology for the ampelographic description of cultivars, to be used for their characterization and evaluation. Therefore, grapevine cultivars have traditionally been characterized and identified by these classical descriptors. However, given the fact that it is based on the analysis of morphological characters, this method is influenced by environmental conditions and the plant development phase. These traditional methodologies have been completed by molecular methods, thus providing a more accurate identification and assessment of grape genetic diversity, that is essential for the accurate management of these genetic resources.

This study aims at the assessment of the genetic diversity of the most important Albanian grapevine varieties as revealed by ampelographic and molecular methods. The results emphasize the informativeness of each employed technique as regards the assessment of the genetic diversity in the set of analyzed samples. The ampelographic evaluation and measurements were performed by using OIV descriptors in mature leaves, shoots, fluorescence, bunch and berry. The sample set was genetically characterized by molecular markers. Some of the ampelographic characteristics as the opening of the shoot tip, petiole length and bunch

identifikim të shpejtë të tyre në koleksione. Niveli i ngjashmërisë ndërmjet varieteteve kryesore të hardhisë rezultoi më i ulët në analizën molekulare sesa në atë ampelografike, duke theksuar nivelin e lartë të diversitetit të varieteteve të analizuara, si dhe fuqinë diferencuese të kësaj metode. Analiza e lidhjeve gjenetike e bazuar në metodën UPGMA i grupoi varietetet e hardhisë në grupe të ndryshme për secilën metode. Megjithatë, në të dyja metodat, në atë ampelografike dhe molekulare, nuk u vunë re grupime bazuar në ngjyrën e frutës apo të përdorimit final të tij. Rezultatet e këtij studimi ndihmojnë në rritjen e efektivitetit të ruajtjes dhe përdorimit të resurseve gjenetike të hardhisë në të ardhmen.

Fjalë çelës: *diversitet gjenetik, metoda, Vitis vinifera L.*

**Andi Rembeci[1], Sokol Çunga[2]**
*[1]Akademia e të Rinjve, departamenti i Historisë i Universitetit të Tiranës*
*[2]Akademia e të Rinjve, Arkivi Qendror Shtetëror*

### Studimet në fushën e paleografisë bizantine dhe pasbizantine në Shqipëri: vlerësime për të shkuarën dhe të tashmen, perspektivat dhe sfidat e së ardhmes

Në fondin arkivor të Arkivit Qendror Shtetëror ruhet një koleksion i veçantë dokumentesh, i emërtuar fondi “Kodikët e Shqipërisë”. Ky fond mban numrin 488 dhe përmban rreth 100 kodikë të dorëshkruar të periudhës bizantine dhe pasbizantine. Rreth këtij koleksioni pak gjëra janë thënë nga pikëpamja e studimeve paleografike, filologjike dhe historike. Një nga çështjet që nuk është prekur në një studim të veçantë është historia e këtyre dorëshkrimeve, si dolën nga dora e përdoruesve të tyre, deri tek strehimi i tyre i sotëm në raftet e arkivave. Gjurmimi i tyre në kohë nëpër shekuj nuk është një detyrë e lehtë, për shkak të mungesës së informacionit. Megjithatë, një përpjekje në këtë fushë mund të bëhet. Në pjesën e parë të kësaj kumtese do të përpiqemi të nxjerrim të gjitha të dhënat historike, që kanë të bëjnë me koleksionin e kodikëve të dorëshkruar të AQSh-së dhe paralelisht do të paraqesim arritjet e deritanishme të kërkimit shkencor në këtë fushë. Do të vlerësohen përpjekjet e mëhershme të përpilimit të katalogëve të dorëshkrimeve

length, resulted discriminative for some grape cultivars suggesting their usefulness in the rapid identification of these varieties among grapevine cultivars. The level of similarity resulted lower in the molecular analysis indicating broad genetic diversity of sample set and the robustness of this technique. The relationships among the assessed grape cultivars based on UPGMA cluster analysis, grouped grapevine cultivars differently for each method. However, no grouping of cultivars was observed based on grape skin color or fruit use by both methods. The results provided in this study greatly enhance conservation and utilization of grape genetic resources for the future

Key words: *genetic diversity, methods, Vitis vinifera L.*

**Andi Rembeci[1], Sokol Çunga[2]**
*[1]Albanian Young Academy. Department of History of University of Tirana.*
*[2]Albanian Young Academy. State Archives of Albania*

## The Researches on the Byzantine and Post-Byzantine Paleography in Albania, assessments about past and present, perspectives and future challenges.

In the Central State Archive of Tirana, Albania, there is a collection of approximately 100 Byzantine and post Byzantine manuscripts, arranged in the Fund "Codices of Albania", bearing the index number 488. On the ground of paleographical or philological studies, few things have been said about this collection. One of the issues that have not been addressed in separate studies, is the history of these manuscripts, how did they come from the hands of their users, to their nowadays lodging in the archive shelves. Chasing them back in time through centuries is not an easy task, due to the lack of information. However, an effort on the field can be done. In the first part of the present paper we will try to bring forth all the historical data relating the CSA's manuscripts collection and at the same time, will present the scientific achievements in this field up to now. We will evaluate the earlier attempts of cataloguing these manuscripts from different authors, whose endeavors date since the 19th century, and while contextualizing them to the circumstances and specific

nga autorë të ndryshëm, që zënë fill që në shek. XIX, duke i inkuadruar me rrethanat dhe kushtet specifike të çdo periudhe, do të vlerësojmë metodologjinë e përdorur në ndërtimin e tyre dhe sa u përgjigjen nevojave të kërkimit shkencor. Ndërsa në pjesën e dytë, duke marrë në konsideratë vështirësitë ekzistuese me të cilat kërkuesit ndeshen sot, kur i drejtohet studimit të dorëshkrimeve të Tiranës, do të japim propozimet tona për zbatimin e metodologjive bashkëkohore shkencore dhe të mjeteve teknologjike në katalogjizimin e kodikëve të dorëshkruar, botimin e katalogëve të dorëshkrimeve dhe shfrytëzimin sintetik të përmbajtjes së tyre, si dhe përdorimin e mjeteve të reja teknologjike në fushën e studimeve paleografike.

Fjalë çelës: *kodikë të dorëshkruar, periudha bizantine, periudha pasbizantine, metodologji, katalogjizim, studime paleografike*

**Ani Bajrami**
*Qendra kërkimore e florës dhe e faunës e Universitetit të Tiranës*

### Teoritë dhe metodat evolucionare në studimin e kulturës: rasti i preferencave për partner seksual afatgjatë

Kultura është koncepti qendror i antropologjisë dhe një nga format kryesore të përshtatjes së njeriut. Ajo konsiderohet produkt i evolucionit biologjik të njeriut dhe mund të përkufizohet si një tërësi sjelljesh të trashëgueshme socialisht nga njëri brez në tjetrin. Evolucioni biokulturor i njeriut është shënjuar nga ndryshime thelbësore të vërejtura te paraardhësit tanë dhe njeriu. Përdorimi i teorisë së evolucionit darvinian, për të shpjeguar origjinën dhe evolucionin e kulturës si dhe përshtatjet kulturore, haset qysh në fillimet e antropologjisë si shkencë. Kështu, për herë të parë, mendimi evolutiv dhe konceptet e përftuara prej ekologjisë, gjetën shprehje në teoritë e propozuara prej L. Morgan-it, E. Tylor-it, L. White-t, J. Steward-it, M. Sahlins-it, R. Rappaport-it etj. Këta antropologë përdorën analogjinë e evolucionit biologjik me atë kulturor, si dhe analizuan kontekstin përshtatës të sjelljeve që kryejnë individët ndaj mjedisit ku jetojnë. Nga ana tjetër, nën ndikimin e sociobiologjisë dhe ekologjisë së sjelljes, N. Chagnon-i i shpjegoi sjelljet sociale te Yanomamo-t nën optikën evolucionare, duke

conditions of their time, we will evaluate the methodology used in compiling them and how they respond to the nowadays needs of researches. While in the second part, taking in consideration the existing difficulties which researchers encounter while trying to address to the Tirana manuscripts, we will propose some contemporary scientific methodologies and technologies in cataloguing the manuscripts, on publishing these catalogues and synthetically utilizing their content, as well as using new technological means on the paleographic studies.

Fjalë çelës: *byzantium, byzantine manuscripts*, *postbyzantine manuscripts, medieval history, methodology, catalography, palaeographical studies*

**Ani Bajrami**
*Flora and Fauna Research Center of University of Tirana*

**Evolutionary theories and methods in studying culture: The case of long-term mate preferences**

Culture is a central theme in anthropology and constitutes an essential part of the human adaptation. It is considered a biological evolutionary product and can be defined as socially transmitted behaviors along generations. Bio-cultural evolution of humans has been accompanied by important changes in humans and our predecessors which include bipedalism, tool making, abstract thought and symbolic language. Since the beginning of anthropology as a science, evolutionary theory has been extensively used to understand and analyze the origin and the evolution of culture and cultural adaptations. Hence, the evolutionary thought and ecological concepts were first used in anthropological theories proposed by L. Morgan, E. Tylor, J, Steward, L. White, M. Sahlins, R. Rappaport etc. Notably, their work focused on the analogy between cultural and biological evolution and they draw human adaptive behaviors as a set of responses to the environment people lived. Additionally, under the influence of the emerging discipline of sociobiology and behavioral ecology, N. Chagnon portrayed social behaviors among Yanomamo using the the-

integruar teorinë e seleksionit natyror dhe seksual. Në vitet ‘90, teoritë dhe metodat evolucionare u risollën në vëmendje prej punimeve të antropologëve J. Barkow dhe J. Tooby me formulimin fillestar teorik prej tyre të mekanizmave të evoluar psikologjikë (MEP). Një studim i kryer në Gjirokastër në lidhje me preferencat për partner afatgjatë ndër shqiptarë, minoritetin grek dhe komunitetet kulturore arumune dhe rome dëshmoi se mes meshkujve dhe femrave nuk kishte diferenca të theksuara. Në këtë artikull, teoritë dhe metodat evolucionare do të përdoren për të analizuar kulturën, konkretisht, ato tipare të saj që lidhen me zgjedhjet për partner seksual afatgjatë. Gjetjet kryesore të studimit do të përdoren për të ilustruar pohimet kryesore të sociobiologjisë, ekologjisë së sjelljes dhe psikologjisë evolutive. Në mendimin tonë, llojshmëria e tipareve kulturore në lidhje me preferencat për partner afatgjatë dhe moshën në martesë i detyrohet jo vetëm veprimit të seleksionit seksual, por dhe atij kulturor. Ky pohim kundërshton disi mendimet e shprehura dikur mbi veprimin e seleksionit seksual tek njeriu. Studime të mëtejshme të kësaj natyre dhe përdorimi i analizës evolucionare në trajtimin e kulturës do të na ndihmojë t’i kuptojmë tiparet e saj si përshtatje, në analogji me përshtatjet biologjike që vëzhgohen ndër organizmat e tjerë të gjallë.

Fjalët çelës: *teoritë evolucionare, kultura, përshtatjet kulturore, preferencat për partner seksual afatgjatë, seleksion seksual, seleksion kulturor, Shqipëri*

**Ardian Muhaj**
*Instituti i Historisë i Akademisë së Studimeve Albanologjike, Tiranë*

## Inercia metodologjike në historiografinë shqiptare të shekullit XXI. Shkaqe dhe pasoja

Historiografia shqiptare e dy dekadave të para të shek. XXI duhet kuptuar në kuadrin e përgjithshëm të shoqërisë në tërësi, e cila përballet me problemet e një tranzicioni të zgjatur, që, në fakt, mund të shihet më qartë nëse e konceptojmë më fort si një inerci nga një periudhë e mëhershme, sesa si lëvizje e mirorientuar drejt një caku të përcaktuar qartë. Në këtë aspekt, historiografia shqiptare, ashtu si edhe tërësia e shoqërisë, ndodhet në një farë mase e ngujuar ende në shek.XX, apo në atë që do të mund

ories of natural and sexual selection. During 1990s, the evolutionary theories and methods were used by anthropologists J. Barkow and J. Tooby to theoretically develop the evolved psychological mechanisms (EPM). A study regarding mate choice and mate preferences in Albanians, Greek minority, cultural communities of Aromanian and Roma living in Gjirokaster has shown that men and women did not differ drastically in relation to mate preferences as expected. This article will use evolutionary theories and methods to analize culture, hence, those cultural traits regarding mate choice and preferences. Key findings from the study will be used to illustrate the main assumptions derived from sociobiology, behavioral ecology and evolutionary psychology. In our opinion, variations on cultural traits in relation to mate preferences and age at marriage can be considered product of cultural selection. Therefore, sexual selection is not the main mechanism involved and responsible for mate preferences in humans as traditionally held. Further studies regarding mate preferences and the use of evolutionary analysis in studying culture will foster understanding of its traits as adaptations, in analogy with biological adaptations observed in other living organisms.

Keywords: *evolutionary theories, culture, cultural adaptations, mate preferences, sexual selection, cultural selection, Albania*

**Ardian Muhaj**
*Institute of History of of the Academy of Albanological Studies, Tirana*

### Methodological inertia in the Albanian historiography of the 21st century. Causes and consequences

Albanian historiography of the first two decades of the 21st century should be understood in the general context of society as a whole, which faces the problems of a prolonged transition, that can in fact be more clearly seen if we conceive it as an inertia from a previous period rather than a well-oriented movement towards a clearly defined aim. In this respect, Albanian historiography as well as the whole of society is somewhat confined in the twentieth century, or in what could be considered

të konsiderohet si shekulli i gjatë i njëzetë shqiptar. Metodat dhe qasjet nuk kanë ndryshuar në përputhje me zhvillimet ballkanike dhe europiane, madje tkurrja e burimeve ekonomike dhe njerëzore në komunitetin e historianëve ka sjellë një konservatorizëm të dukshëm në tërësinë metodologjike, që njëkohësisht i përshtatet trendit të përgjithshëm të inercisë shoqërore, por edhe kontribuon në këtë zgjatje të shekullit të njëzetë historik edhe në shekullin e njëzetenjëtë kronologjik. Paradigma dhe diskursi mbizotërues, po ashtu, e ndjekin ritmin e kësaj inercie historiografike. Shkaqet e një inercie apo zgjatje të periudhës historike dhe historiografike përtej periudhës kronologjike janë të shumta dhe mund të grupohen si shkaqe të përgjithshme, pra që janë gjithëshoqërore, dhe të përveçme, shkaqe të lidhura me vetë disiplinën shkencore të historisë. Pasojat gjithashtu janë gjithëshoqërore dhe disiplinore. Reformimi metodologjik i historiografisë shqiptare natyrisht nuk mund të pritet që të ketë një dinamikë dukshëm më të përshpejtuar sesa transformimi i përgjithshëm i shoqërisë. Megjithatë, historianët dhe historiografia janë një nga komunitetet, përkatësisht fushat, që lipset të jenë në ballë të reformimit dhe transformimit të përgjithshëm shoqëror drejt një caku të projektuar në të ardhmen dhe të daljes nga pesha e inercisë së shekullit XX. Në të tilla periudha, kur e kaluara peshon aq rëndë në të tashmen dhe të ardhmen, reformimi metodologjik, përmes zgjerimit dhe rikonceptimit të qasjeve dhe metodave të hulumtimit, duhet të shihet e lidhur ngushtë me ndërgjegjësimin mbi efektin që ka ripërshtatja e subjektit hulumtues (historianit) ndaj vetë fushës së studimit. Reformimit metodologjik duhet t'i paraprijë ose duhet të shkojë paralelisht me përshtatjen e historianit ndaj zhvillimeve të shoqërisë dhe të shkencës historike.

Fjalë çelës: *historiografia, inercia metodologjike, shkaqet, pasojat, reformimi metodologjik*

**Arta Xhika**
*Departamenti i letërsisë dhe gazetarisë i Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan*

## Dy metoda në përqasje: nga shkolla e Romës në ato të Kalabrisë dhe Palermos

as the long 20th century. Methods and approaches have not changed in line with Balkan and European developments. The shrinkage of economic and human resources in the community of historians has brought a remarkable conservatism to the methodological entirety that at the same time fits the general trend of social inertia, but also contributes to this extension of the twentieth-century century even in the twenty-first chronological century. The prevailing paradigm and discourse also follow the rhythm of this historiographical inertia. The causes of an inertia or prolongation of the historical and historiographical period beyond the chronological period are numerous and can be grouped as general causes, that is, all of them sociologically and specifically, therefore, related to the scientific discipline of history itself. The consequences are also social and disciplinary. The methodological reformation of Albanian historiography can of course not be expected to have a significantly more accelerated dynamics than the general transformation of society. Yet historians and historiography are one of the communities, respectively the areas that must be at the forefront of reform and overall social transformation towards a future-designed goal. In such periods when the past weighs so heavily in the present and the future, the methodological reform, through the expansion and re-conception of research approaches and methods, should be closely related to the awareness of the re-adaptation of the research subject (historian ) to the field of study itself. The methodological reformation must precede or go hand in hand with the adaptation of the historian to the development of society and historical science.

Keywords: *Historiography, methodological inertia, causes, consequences, methodological reformation*

**Arta Xhika**
*Department of Literature and Journalism of University "Aleksandër Xhuvani" of Elbasan*

**Two methods of approach: from Rome schools to those in Calabria and Palermo**

Shkolla filologjike e Giuseppe Gradilone-s, që ka bartur peshën më të madhe në tejkalimin e shkollës kulturologjike të Koliqit, vjen në letrat shqipe si forma më e mirëkonturuar e filologjizmit klasik.

Nga ana tjetër, me ndërmjetësinë e Solanos dhe të Pipës shkolla filologjike e arbëreshëve të Jugut, sidomos Altimarit dhe Mandalasë, propozoi një filologjizëm modern, në përputhje me natyrën e traditës letrare shqiptare, të lindur drejtpërdrejt nga mekanizmi i gjallë i gjuhës popullore.

Veprat e shkrimtarëve arbëreshë, veçanërisht ajo e De Radës, janë bërë fillimisht pjesë e kritikës së këtij prizmi filologjik. Megjithatë shkolla filologjike njeh zhvillime të ndryshme ndër kritikë, ndryshime që i atribuohen faktorit kohë dhe vend.

Punimi synon të sjellë në vëmendje dy shkolla, atë të Romës dhe atë të Kalabrisë e Palermos, me përfaqësuesit e tyre që përdorin kritikën filologjike.

Fjalët çelës: *Filologji, filologjizëm klasik, filogjizëm modern, traditë letrare, kritika diasporës, shkollë kulturologjike*

**Belfjore Qose**
*Akademia e të Rinjve, departamenti i letërsisë i Universitetit të Tiranës*

## Sfidat që lidhen me përdorimin e metodologjive të reja në studimin e letërsisë shqipe

Historia e studimeve të letërsisë shqipe ka pësuar një reformim thelbësor, i cili është pasuar edhe nga ndryshime të metodologjive të mësimdhënies së lëndëve të ndryshme të letërsisë në universitete apo edhe në sistemin parauniversitar. Siç është e ditur, deri në vitet '90 metodologjia që përdorej për studimin e letërsisë ishte ajo realiste, edhe më saktësisht ajo e realizmit socialist. Studimet pozitiviste, të mbështetura në metodat e jashtme të studimit të letërsisë, përbënin një dukuri që dukej e tejkaluar për kohën, ndërkohë që në botë formalizmi dhe strukturalizmi ishin në kulmin e shkëlqimit të tyre, të debateve për to, me gjithë dyshimet dhe kundërthëniet me të cilat përcilleshin herë pas here.

The philological school of Giuseppe Gradilone, who has carried the greatest weight in overcoming Koliqi's cultural school, comes in the Albanian letters as the best well-outlined form of the classic philology.

On the other hand, with the contribution of Solano on one side and Pipa on the other hand, the philological school of southern Arbëresh-es, especially of professor Altimari and Mandala, propose a modern philology, in line with the nature of the Albanian traditional literature, born directly from the living mechanism of the folk language.

The literary works of Arbëresh writers, especially the De Rada's literary work, originally became part of the criticism of this philological prism.

However, the philology school recognizes different developments among the critics, changes that are attributable to time and place factor.

This paper intends to bring to attention two schools, that of Rome and that of Calabria and Palermo, with their representatives using philological criticism.

Keywords: *Philology, Classical philology, modern philology, traditional literature, Diaspora critics, cultural school*

**Belfjore Qose**
*Albanian Young Academy. Department of Literature of University of Tirana*

## The challenges of using new methodology in studies on Albanian literature

The Albanian studies on our literature has changed so much, being from time to time reformed, by the very fact that the object itself, Albanian literature, has changed a lot after the fall of the dictatorship; at the other side the methodology of teaching in universities and schools has also been reformed. It is now a well-known fact that before the '90s, social realism prevailed the literature and the methodology used in studying literature. The positivism, based mostly in methodologies that did not study the literature in itself, was an old methodology, that was left behind by the new literary theories, such as Formalism, Structuralism, New Criticism etc., which dominated the century, regardless of the debates upon them.

Një sërë ndryshimesh ndodhën në mënyrën se si shihej letërsia, ku metodologjitë e reja vendosën në qendër, me ngulm, tekstin letrar. Konferenca shkencore "Letërsia si e tillë" ndryshoi katërçipërisht konceptet për tekstin letrar dhe dëshmoi vullnetin e tërë komunitetit të studiuesve për t'iu afruar metodologjisë bashkëkohore të studimit të letërsisë. Lëndë të reja universitare ndryshuan konceptin për metodologjinë që në auditorë, të tilla si "Teoritë letrare moderne" etj. Ndryshimet ishin të dukshme. Në studimet shqiptare metodologjia, por edhe bibliografia e përdorur, filloi të kishte në qendër emra krejt të tjerë studiuesish, nga Zheneti, Todorovi, Barti e deri tek Linda Hatçeon.

Por a mjafton ky kthim i vëmendjes nga teksti, sot kur disiplinat e pastra janë pothuaj në periferi të vëmendjes së studimeve? A duhet që metodologjia pastërtisht formaliste apo strukturaliste të izolojë marrëdhëniet e letërsisë me kulturën, psikologjinë, sociologjinë, antropologjinë, artet e tjera? Metodologjia është sërish në transformim. Kërkohet, siç duket, një ekuilibër mes metodologjive pastërtisht të mbështetura në tekstin letrar, të teorive të receptimit, të letërsisë së krahasuar dhe të interdisiplinaritetit. Gjithashtu, do të ndalemi në këtë studim edhe në metodologjinë postmoderne dhe studimet në letërsinë shqipe. Ku fillon studimi për postmodernitetin në letrat shqipe dhe ku përfundon fabrikimi i studimeve? Këto janë disa prej çështjeve në të cilat do të ndalemi gjatë punimit tonë.

Fjalë çelës: *strukturalizëm, formalizëm, modernitet, studime ndërdisiplinore*

**Blerta Avdia**
*Departamenti menaxhim-turizëm i Kolegjit Universitar "Logos", Tiranë*

### Aplikimi i GIS-it në fushën e turizmit, një risi e kohës

Shqipëria është një vend i cili në vetvete mbart një potencial të madh natyror dhe kulturor, që ndikon ndjeshëm në zhvillimin e turizmit. Turizmi si një sektor i rëndësishëm i ekonomisë ndikon pozitivisht dhe negativisht në ekonomi, shoqëri dhe mjedis. Pasojat negative të turizmit kërkojnë studime më të detajuara dhe shkencore, ku ndërthuren

It was strongly fostered that the text in itself would have to be the core of the literary studies. The Scientific Conference "Literature as it is" (held in Tirana) changed profoundly the concepts of the literary text and showed the will of the scientific community to accept and use the modern methodology of studies, theoretical perspectives and teaching in auditoriums. The curriculums and courses have been changing the concept of the literary and the methodologies in teaching contexts. The Albanian researches on literature changed so much in structure and also in content, one could distinguish in most Bibliographies the names of Genette, Todorov, Barthes, and Lacan and up to L. Hutcheon and J. Culler.

But is this centralization of the text enough to adapt the methodology of Albanian literary studies, when nowadays this concept has changed, by putting the pure aesthetic view of the texts in the peripheral studies (according to H. Bloom)? The dilemmas whereas the Formalism and Structuralism isolated literature from the inseparable relations with culture, psychology, sociology, anthropology and other arts are strong nowadays. The methodology is constantly transforming, a new approach is needed, one which combines the methodology based strictly in the literary text with the Theory of Reception, Comparative Literature and Interdisciplinary methodology. We will also analyze the methodology and the theoretical perspectives used in studying Postmodernism in Albanian literature. Where does the Postmodernism begin and when does the fabrication of researches related to it ends? These are some of the issues we will address in our paper.

Keywords: *Structuralism, Formalism, Modernity, Interdisciplinary studies*

**Blerta Avdia**
*Department of Tourism Management of University College "Logos", Tirana*

### Application of GIS in scope of tourism, as new innovation of time

Albania is a country, which has a lot of natural and cultural potential with sensible impact on tourism development.

The tourism, as important economic sector, has positive and negative impact on the economic, social, environmental development.

metodologjia tradicionale për të arritur në përfundime teorike, marrja e modeleve nga vendet e tjera për t'i zbatuar në praktikë deri tek metodologjitë bashkëkohore përmes software-ve dhe hardware-ve, ku analiza, krahasimet, argumentimet e ndryshme jepen përmes imazheve grafike, hartografike, tabelare.

Modelimi dhe dinamika e fenomenit apo problematikës jepet për periudha të gjata kohore. Një mundësi është përmes integrimit të GIS-it (Sistemi i informacionit gjeografik) si një metodologji e re për paraqitjen më të detajuar të problematikës, evidentimit e shkaqeve, pasojave dhe rekomandimin e zgjidhjeve përkatëse.

Fjalë çelës*: Sistemi i Informacionit Gjeografik (SIG), turizëm, metodologji.*

**Brunilda Çuko[1], Valbona Sota[1], Efigjeni Kongjika[2]**
*[1]Departamenti i bioteknologjisë i Universitetit të Tiranës, [2]seksioni i shkencave natyrore dhe teknike i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë*

**Metodologjitë *in vitro* që shmangin oksidimin polifenolik në eksplante të ndryshme të mollës *(Malus domestica L.)***

Metodat bioteknologjike, kryesisht kulturat indore dhe qelizore *in vitro*, paraqiten si një alternativë efikase ndër teknikat e shumimit të bimëve. Megjithatë, jo rrallëherë ndodh që të hasen probleme dhe kufizim NM "{P0[ në aplikimin e tyre. Kultivimi *in vitro* i mollës, duke përdorur si eksplant fillestar sythe anësore, shoqërohet me çlirim polifenolesh, të cilat pengojnë zhvillimin e mëtejshëm të bimëzave. Qëllimi i këtij studimi është të paraqesë përparësitë dhe kufizimet që shoqërojnë përdorimin e eksplanteve të ndryshme të mollës (*Malus domestica* L.) në përpjekje për të shmangur çlirimin e polifenoleve në terrenin e kulturës. U përdorën eksplante të ndryshme të dy kultivarëve të mollëve të rrethit Devoll (Starking dhe Golden Delicious), si: sythe anësore, fara, embrione zigotikë dhe meristema në terrenin universal MS (Murashige and Skoog) me shtesa ose jo të auksinës ANA (acidi naftalenacetik) dhe citokininës BAP (6-benzilaminopurinë). Në stadin e proliferimit u vëzhgua prania e polifenoleve dhe përqindja e kontaminimit të kulturës. Më tej bimët

The negative impact on tourism requires detailed scientific study which interlink traditional methodology, in order to arrive in theoretical conclusions, taking models from other places and carrying out the implementation with coherent methodology (software and hardware).

The different analyses; comparing data, the arguing, the conclusions, are given through image, graphics, maps, tables.

The modeling and the dynamic of the phenomena or problematic, is given for a long period time.

One opportunity is through GIS integration as a new methodology to present the problematic, the evidence of causes, the consequences and the given solutions.

Keywords: *Geographic Information System (GIS), tourism, methodology*

**Brunilda Çuko[1], Valbona Sota[1], Efigjeni Kongjika[2]**
*[1]Biotechnology Department of University of Tirana. [2]Albanian Young Academy. [3] Section of Natural Technical Sciences of Academy of Sciences of Albania*

## *In vitro* methodologies that avoid polyphenolic oxidation in different explants of apple (*Malus domestica* L.)

Biotechnological methods, especially *in vitro* tissue culture, look like an efficient alternative among the plant multiplying techniques. But, sometimes there are problems that limit their application. Apple *in vitro* cultivation, using axillary buds manifest polyphenols release in the nutrient medium which inhibit the plantlets growth. The aim of this study was to display the advantages and disadvantages of different apple (*Malus domestica* L.) explants usage due to eliminate the polyphenol release. Various explants of two apple cultivars (cv.Starking and cv.Golden Delicious) from Devoll district was used like: axillary buds, seeds, zygotic embryo and meristem in the universal medium MS (Murashige and Skoog) with addition or not of auxin NAA (α-naphthaleneacetic acid) and cytokinin BAP (6-benzylaminopurine). During the proliferation stage, the presence of polyphenols and the contamination percentage was detected. Then, the plantlets passed to some subculture stages, rooting and acclimati-

kalohen në disa subkultura, rrënjëzim dhe aklimatizim. Kultura e sytheve shfaqi një përqindje të lartë kontaminimi dhe, pavarësisht manipulimeve të ndryshme, prania e polifenoleve në terren është e pashmangshme. Kultura e farave dhe embrioneve zigotikë rezultoi me një përqindje të ulët kontaminimi, 15% dhe deri në 0% përkatësisht, dhe në asnjë rast nuk u shfaq prania e polifenoleve në terren. Por përdorimi i tyre është i kufizuar vetëm në rastet e prodhimit të formave të reja nga hibridizimi i interspecieve dhe ndërgjinore kur duhet "shpëtuar" embrioni nga dështimi për arsye të ndryshme. Kultura e meristemës është një alternativë e vlefshme në rastet e përftimit të bimëve të shëndetësuara, por teknika paraqitet e vështirë dhe ka një përqindje relativisht të ulët të bimëve të përftuara (28.6%). Subkulturat e vazhdueshme mund të rrisin progresivisht numrin e bimëzave të përftuara, por duhet marrë parasysh në këtë rast shfaqja e variacioneve somaklonale. Terreni me sasi të përgjysmuar i makroushqyesve dhe me 0.1mg $l^{-1}$ ANA rezultoi efikas në rrënjëzimin e 90.2% të bimëzave të testuara, nga të cilat vetëm 60% arritën të mbijetojnë pas stadit të aklimatizimit. Përzgjedhja e një eksplanti për kultivimin *in vitro* të mollës duhet të bëhet gjithmonë bazuar në qëllimin e ngritjes së kulturës, duke patur parasysh avantazhet dhe disavantazhet e tij.

Fjalë çelës: *molla, eksplant, polifenole, embrion zigotik, kultura e meristemës, rrënjëzim, aklimatizim*

**Edelajda Çepa**
*Akademia e të Rinjve, departamenti i letërsisë dhe i gazetarisë i Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan*

### Metoda të kërkimit shkencor në filologji. Lef Nosi si studiues dhe objekt studimi

Në studimet filologjike në vijimësinë e kohës përgjithësisht ka patur dy a më shumë shkolla filologjike, që mbështeteshin në koncepte të ndryshme mbi atë se ç'është filologjia e që propozonin qasje diametralisht të kundërta për objektin e filologjisë, metodologjitë dhe teknikat e studimit. Filologjia shqiptare dhe metodat e kërkimit shkencor në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore iu qasën totalisht shkollës së

zation stage. The axillary buds cultivation appears a high contamination percentage and presence of polyphenols in the nutrient medium was inevitable despite the various manipulations. Seeds culture and zygotic embryos culture resulted with a low contamination percentage 15% and until 0% respectively and there was not polyphenole presence in all the cases. But, their application is limited only during the creation of new varieties from the interspecies and intergenus hybridization when the embryo has to be "saved" from the abortion that may happen for many reasons. The meristematic culture is a valid alternative when free-viruses plants are required but this technique appears technically difficult and the percentage of obtained plants was relatively low (28.6%). Continuous subcultures may increase progressively the number of obtained plants but might be taken in consideration that somaclonal variations may occur. The medium with half macronutrient concentration and 0.1mg l-1 NAA resulted effective in the rooting induction of 90.2% of tested plants , from which only 60% survived after the acclimatization stage. The explants selection for apple *in vitro* cultivation might be done based on the purpose of the tissue culture considering its advantages and disadvantages.

Keywords: *apple, explants, polyphenols, zygotic embryo, meristem culture, rooting, acclimatization*

**Edelajda Çepa**
*Albanian Young Academy. Department of Literature of University "Aleksander Xhuvani", Elbasan*

### Methodology of scientific research in Philology - Lef Nosi as a researcher and an object of research

The philological studies have been generally oriented by two or more philological schools, which were based on various concepts on what philology is and which proposed diamatrically distinctive approaches about the philological object of study, the methodologies and study techniques. After the Second World War, the Albanian philology and scientific research methodology, also affected by ideological and socio-cultural conditions were completely approached to the Eastern school.

Lindjes, ndikuar dhe prej kushteve social-kulturore e ideologjike. Metoda ishte krejt e kontrolluar nga dialektika e shkencës, pra si të ishte objekti do të ishte edhe metoda. Objekti përcaktonte metodat, duke i vënë ato "në shërbim" të tij, madje dhe mënyra e përdorimit të këtyre metodave shpesh dilte jashtë etikës së kërkimit shkencor, pasi mjaft materiale burimore ishin të koduara dhe kriptuara dhe referimi ishte krejt hermetik, apo mungonte fare. Edhe kur ishin, citatet shërbenin thjesht si ambalazhim.

Sot, sjellja filologjike e studiuesit mbetet e pandikuar, pa u udhëzuar nga "të tjerët". Interes ka teksti *in se*, pra teksti në vetvete. Sot filologu ka lirinë ta shohë tekstin në evolucion, nga dorëshkrimi i parë tek i dyti, duke synuar qartësimin e punës së autorit për përsosjen estetike të kumtit.

Në studimin mbi fondet arkivore "Lef Nosi", tri fakte vihen në simbiozë mes tyre: Lef Nosi si fondkrijues; filologjia si disiplinë që synon të arrijë në tekstin burimor; fakti që këto fonde kanë qenë të mbyllura për studiuesit për gjysmë shekulli; duke të udhëzuar drejt kërkimit arkivor të thelluar. Duke patur një fond të panjohur me objekte të natyrave të ndryshme në përmbajtjen e tij, lipsej të përdoreshin metoda po aq të ndryshme të kërkimit, pa u ndikuar nga ndonjë qëllim i paracaktuar, të cilat gjithsesi në fund të punës kërkimore evidentonin objekte të qarta studimi, duke u mbështetur fort në tekstin në vetvete. Kjo qasje e ndryshuar e studimeve dhe metodave të kërkimit shkencor në Shqipëri, ku në thelb dhe në qendër të studimit dhe vëmendjes së studiuesit, kritikut të tekstit, është dhe mbetet teksti, i jep vlerën që i takon tekstit burimor si një njësi bazë dhe e patjetërsueshme e filologjisë.

Fjalë çelës: *filologji, metodë, objekt, qëllim, dialektikë, tekst, kontekst.*

**Edlira Gugu**
*Departamenti i letërsisë dhe i gazetarisë i Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan*

### Metodologjia e Rexhep Qosjes mes risisë dhe traditës në shkencën letrare shqiptare

Punimi merr në konsideratë një vështrim mbi metodologjinë e punës të ndjekur prej një nga përfaqësuesit më në zë të shkencës për letërsinë: akademik Rexhep Qosja.

The method was mainly controlled by scientific dialectics. Therefore, the object of study would be the adapted to the methodology.

The object of study 'suggested' the methodology of scientific researches. Even the manner of use of these methods often surpassed the ethics of scientific researches. This phenomenon would happen because of a great amount of sources materials, which were encoded and encrypted and the reference was practically hermetic, or lacked at all. Even when the quotations were provided, they simply served as a covering.

Nowadays, the researcher's philological attitude remains intact, without being guided by 'others'.

The text itself became of major interest. Presently, the philologist enjoys the freedom of analysing the textual evolution from the first to the second manuscript, emphasizing the author's work towards esthetical perfection.

In the study on archive funds 'Lef Nosi', three facts which are put into symbiosis: Lef Nosi as a creative fund, philology as a discipline that aims to reach the source text , the fact that these funds have not been accessable to people for nearly half a century, leading through the detailed archival research.

Having an unknown fund with objects of study of different kinds in its content, required the usage of different research methods, without being affected by any predetermined purpose, which after call the research work were identified clear objects of study based on the text itself. This transformed approach of studies and scientific research methods in Albania, where in the centre of the study and the researcher attention, the text critic is and remains the text itself, attributes the respective values to the resource text as a main and inalienable unit of philology.

Keywords; *philology, methodology, object, purpose, dialectics, text, context*

**Edlira Gugu**
*Department of Literature of University "Aleksander Xhuvani", Elbasan*

### The methodology of Rexhep Qosja between the inovation and the tradition in Albanian researches on literature

The aim of this paper is to point out the methodology of the great opus of one of the well-known representatives of literary criticsism: Rexhep Qosja.

Gjatë veprimtarisë së tij shkencore ai shfaqet si një studiues me përmasë të gjerë, kritik dhe historian i letërsisë, me një larmishmëri në fokus studimi të shkrimtarëve të traditës dhe letërsisë bashkëkohore. E gjithë puna e tij karakterizohet në aplikimin e një sërë metodash kërkimi, përdorimi i të cilave ka ardhur si nevojë dhe domosdoshmëri e lidhur ngushtë me objektin e saj.

Në këtë mënyrë fokus i punës sonë nuk është vetëm evidentimi i tyre, por një vështrim mbi: mënyrën si është zhvilluar e integruar gërshetimi i metodave tradicionale me ato bashkëkohore, në funksion të përpunimit të një metode individuale kërkimi; si është zhvilluar ajo nga fillimet e punës kërkimore të studiuesit në vepra më të vona të tij; si kanë ndikuar ato në përforcimin e traditës e më tej hapjen e rrugëve, perspektivave dhe këndvështrimeve të reja për kërkim.

Punimi e shtrin vështrimin e tij në ato vepra me karakter studimor të Qosjes, në të cilat është menduar se profili i tij si studiues, kritik e historian i letërsisë përvijohet në mënyrë të plotë (është fjala për veprat: “Dialogje me shkrimtarë”, “Kontinuitete”, “Asdreni: jeta dhe vepra e tij”, “Porosia e madhe”, “Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi I, II, III” dhe krijon mundësi për t’u realizuar më së miri.

Gjithashtu ai e realizon këtë vështrim duke marrë në konsideratë edhe kontekstin e zhvillimit të kritikës letrare dhe historisë së letërsisë në Shqipëri pas viteve ‘45 dhe para viteve ’90, pasi kjo periudhë kohore mendojmë se ngjall interes për shkak të natyrës së veçantë edhe të kontekstit historik të saj.

Fjalë kyç: *metoda, traditë, risi, histori e letërsisë, historian i letërsisë, kritika letrare, ndikim, kërkim shkencor, periudhë.*

**Elsa Skënderi-Rakipllari**
*Departamenti i gjuhës shqipe i Universitetit të Tiranës*

### Qasje metodologjike të gjuhësisë së sotme

Kjo kumtesë rreh të trajtojë çështje të qasjeve metodologjike të gjuhësisë së sotme, të cilat kanë prirjen të jenë shumë- e ndërdisiplinore, duke u ndalur më konkretisht te disa metoda të caktuara që lidhen edhe me drejtimet gjuhësore më të spikatura, si: gjuhësia historiko-

During his scientific activity he comes out as a great scholar, critic and literature historian, with a diverse focus in studying the traditional Albanian writers, as well as contemporary literature. His whole work is featured in applying of several research methods, their using is asked as a necessary need closely linked with its object. In this way our work focus is not only in identifying them out, but in over viewing the way of the development and integration of traditional methods with contemporary ones, helping the process of individual researching methodology; how is it developed from the beginning of scholar research work to his latest works; how have they influenced in traditional reinforcement as well as finding out ways of searching new perspectives and viewpoints and has the scholar achieved the expected goal.

The paper spreads its viewpoint in those works with a studying character of Qosja where his literary critic and historian profile is fully revealed (we are talking about these works “Dialogue with writers” , “Continuities”,” Asdreni, his life an opus”, “The Great Message”, “The History of Albanian Language – Romanticism I, II, III” and finds out possibilities to realize them well.)

He is fulfilling this viewpoint taking into consideration even the context of literary critic and the history of literature development in Albania after the years ‘45 and before the years ’90 because we thought this time period breed interest due to its special nature and historical context.

Key words: *methods, tradition, innovation, history of literature, historian of literature, literary criticism, influence, scientific research, period*

**Elsa Skënderi-Rakipllari**
*Department of Albanian Language of University of Tirana*

## Methodological approaches of modern linguistics

This paper seeks to examine the methodological approaches of modern linguistics, which tend to be multi- and inter-disciplinary, by focusing more concretely on certain methods that also are connected to the most salient linguistic schools, such as: comparative- historical linguistics, structuralism, American descriptivism, generativism, functionalism and

krahasuese, strukturalizmi, deskriptivizmi amerikan, gjenerativizmi e më tej te funksionalizmi dhe lëmì përbërës të tij. Lëvrimi i këtyre metodave të larmishme është ndikuar sa nga prirja për ta konsideruar e formësuar gjuhësinë si një disiplinë autonome dhe po aq edhe nga metodat hulumtuese kompjuterike, të cilat janë një pasojë fatlume e revolucionit të katërt industrial dhe që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me fusha të reja studimore, si p.sh. gjuhësia e korpuseve. Më tej kumtesa trajton prirjet dhe kahjet metodologjike që janë shfaqur në studimet gjuhësore shqiptare, duke bërë një përqasje mes metodës deskriptive dhe preskriptive. Deri në vitet '70 studimet gjuhësore qenë studime deskriptive me synim preskriptivizmin gjuhësor, të cilat do të kulmonin me hartimin e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe dhe të Gramatikës së Akademisë. Sakaq, pas viteve '70 vihet re një deskriptivizëm në suazën e preskriptivizmit. Studimet në këtë periudhë kanë prirjen të orientohen jo drejt varieteteve të ndryshme gjuhësore, por drejt lëvrimit të një gjuhësie në funksion të krijimit të standardit të gjuhës shqipe. Ndërsa ende sot mungojnë studime që zbatojnë metoda të mirëfillta deskriptive për studimin e gjuhës së folur, apo të mbështetura në korpuse përfaqësuese të gjuhës shqipe, ndaj me këto mangësi e nevoja lidhen po ashtu edhe rekomandimet që sugjeron kumtesa në fjalë.

Fjalët çelës: *deskriptivizëm, gjuhë, gjuhësi, metoda, preskriptivizëm.*

**Epidamn Zeqo**
*Kërkues i pavarur*

## Teoria e zgjedhjes racionale – themeli qëllimisht i gabuar i sjelljes i neoliberalizmit?

Seneca (sipas traditës së stoikëve): *Bona rerum, secundarum optabilia, adversarum mirabilia*. "Gjërat e mira, të cilat i përkasin prosperitetit, mund të jenë të dëshirueshme; por gjërat e mira që u përkasin fatkeqësive, duhet të admirohen."

Teoria e zgjedhjes racionale ose utilitarianizmi supozon se shoqëritë janë agregate të individëve egoistë, që janë maksimizues të fitimit; krijojnë rangun e preferencave sipas interesave të tyre egoiste, të nxitura nga maksimizimi i shërbimeve. John S. Mill-i e përcaktoi utilitarizmin në

its sub-branches. The development of these methods was influenced on one hand by the tendency to consider and shape linguistics as an autonomous discipline and on the other hand by computer assisted research methods, which might be considered as a fortunate consequence of the fourth industrial revolution, and which also relate to new fields of study, such as corpus linguistics. The paper focuses also on the methodological tendencies and directions that have emerged in the Albanian linguistics, by comparing the methods of descriptivism and prescriptivism. Up to the '70s the linguistic studies were mainly descriptive, but with the aim of reaching prescriptivism, and their main accomplishment might be considered the establishment of the Orthography of the Albanian language and of the Grammar textbooks of the Albanian Academy of Science. After '70s the descriptivism may be noticed within the settings of prescriptivism. The studies of this period have a tendency to be oriented not toward different language varieties, but toward a linguistics that aims to shape the standard of the Albanian language. Meanwhile, today there is a lack of studies that apply suitable descriptive methods to study the spoken language, or to rely on representative corpora of the Albanian language. Related to these shortcomings are also the recommendations of the present paper.

Keywords: *descriptivism, language, linguistics, method, prescriptivism.*

**Epidamn Zeqo**
*Independent Researcher*

### Of Rational Choice Theory - The Purposefully Erroneous Behavioural Foundation of Neoliberalism?

Seneca (after the manner of the Stoics): *Bona rerum, secundarumoptabilia, adversarummirabilia.*'That the good things which belong to prosperity are to be wished; but the good things that belong to adversity are to be admired.'

The Rational Choice Theory or Unitarianism assumes societies are aggregates of selfish individuals whom are gain maximisers; ranking preferences according to their selfish interests driven by utility maximi-

mënyrë të ngjashme me atë se si bëri Jeremy Bentham-i, babai i traditës utilitariste. “Lumturia” tha Benthami “është objekti i vetëm i mundshëm i dëshirës, prandaj lumturia është e llogaritshme.” Milli shkoi edhe më tej duke shtuar një pjesë të dytë, që bie ndesh me të parën, sipas së cilës “besimi që pranon si themel të moralit utilitetin, ose që parimi më i madh është lumturia, konsideron se veprimet janë të drejta në proporcion, pasi ato tentojnë të nxisin lumturinë dhe janë të gabuara, pasi ato tentojnë të nxisin të kundërtën e lumturisë.”

Milli ndryshe nga Benthami e bazon utilitarizmin në motive sociale, në “ndjenjat shoqërore të njerëzimit – dëshirën për të qenë në unitet me krijesat e njëllojta.” Ai pohon se është më mirë të jesh “Sokrat i pakënaqur, sesa derr i kënaqur.” Prandaj kjo doktrinë, që njeriu sipas natyrës është një qenie shoqërore, nënkupton atë që shoqëria nuk mund të konsiderohet si një grup individësh, që lëviz vetëm nga motive egoiste. A nuk është ekzistenca e ndërvarësisë, vlerave dhe altruizmit një forcë e fuqishme në formësimin e preferencave dhe vendimeve? Altruizmi është antiteza e egoizmit (rrjedh nga latinishtja: *alter huic* “tek kjo tjetër”). Amartya Sen në artikullin e tij themelor “Rational Fools” godet një terren të mesëm, “të dyja –izmat janë koncepte ekstreme dhe se në realitet njeriu është një qenie më e balancuar.”

Por pse shkencëtarët socialë neoliberalë këmbëngulin që të gjithë janë egoistë dhe vazhdojnë të zhvillojnë modele dhe politika, të cilat vetëm pasqyrojnë këtë themel të gabuar të sjelljes, por që qeverisin sot jetët tona? Si mund të jenë të sakta kur themeli është i gabuar? A është njeriu një qenie njëdimensionale? Për shkak të natyrës vetëpërmbushëse të politikave, a po krijojnë një individ dhe shoqëri më të mirë (utopi) apo një shtrembërim (utopi negative)? A kanë krijuar qytetarë apo konsumatorë? Për më tepër, a është e llogaritshme lumturia – a mund të ketë një dëshirë të veçantë për lumturi kundrejt dëshirës për objekte?A mund të jemi me të vërtetë të lumtur para se të përjetojmë dhimbje? A është më mirë të jesh Sokrat i pakënaqur apo derr i kënaqur? A nuk është e vërtetë që ylberi nuk mund të formohet dot pa shi?

Ky studim kërkon t’u përgjigjet këtyre pyetjeve ekzistenciale, duke adresuar problemet metodologjike të krijuara në modelet dhe politikat neoliberale, duke analizuar kryesisht – si në utilitarizmin e Millit – kontradiktat në librat e Machiavelli-t, Princi dhe Diskutimet, dhe në librat e Adam Smith-it, Pasuria e Kombeve dhe Teoria e Ndjenjave Morale. Dua

sation. John S. Mill defined Utilitarianism similarly to how the father of the Utilitarian tradition – Jeremy Bentham, did. 'Happiness' stated Bentham 'is the sole possible object of desire, therefore pleasure is calculable.' However, Mill went even further adding a second part which contradicts the first, that 'the creed which accepts as the foundation of morals utility, or the greatest happiness principle, holds that actions are right in proportion as they tend to promote happiness, wrong as they tend to promote the reverse of happiness.'

Mill unlike Bentham bases Utilitarianism on social motives 'the social feelings of mankind - the desire to be in unity with our fellow creatures.' He states that it is 'better to be Socrates dissatisfied then a fool satisfied.' Hence, this doctrine that man by nature is a social being means that society cannot be regarded as an aggregate of individuals, moved only by self-seeking motives. Is it not the existence of interdependence, values and altruism a powerful force in shaping preferences and decisions? Altruism is the anti-thesis of egoism (from latin: *later huac* 'to this other'). Amartya Sen in his seminal article 'Rational Fools' strikes a middle ground, 'both –ism are extreme concepts and that in reality what you get is a centred man.'

So why do neoliberal social scientists insist that everyone is selfish, and carry on developing models and policies that only reflect this erroneous behavioural foundation, but that govern our lives today? How can they be correct when the foundation is wrong? Is a man a one-dimensional being?Because of the self-fulfilling nature of policies, are they creating a better individual and society (utopia) or a distortion (dystopia)? Have they created citizens or consumers? Moreover,is happiness calculable - can one separate desire for pleasure versus desire for objects? Can you be truly happy without before experiencing pain? Is it better to be Socrates dissatisfied then a fool satisfied? Is it not true that rainbows cannot form without rain?

This paper seeks to answer these existential questions, those addressing the methodological issues of neoliberal models and policies,by primarily analysing – like in Mill's Utilitarianism – thecontradictions in Machiavelli's books The Price and The Discourses, and in Adam Smith's books The Wealth of Nations and The Theory of Moral Sentiments. Therefore, demonstrating that these thinkers – propagandised as the fathers of pragmatism, selfishness and free markets – have had their works

të demonstroj që këta mendimtarë – të propaganduar si baballarët e pragmatizmit, egoizmit dhe tregjeve të lira – i kanë patur veprat e tyre të cituara në mënyrë selektive nga ekspertët neoliberalë, që në vitet '80, për të përligjur implementimin e neoliberalizmit. Kohët e fundit shkencëtarët socialë, si Thomas Piketty – i cili përdor metoda ndërdisiplinore – po dëshmojnë, se politikat neoliberale janë problematike dhe se ndihmojnë ata të paktët që zotërojnë kapitalin, jo shumicën rrogëtare.

Fjalë çelës: *utilitarizmi, neoliberalizmi, altruizmi, individualizmi, shoqëria, utopia*

**Erarba Çiraku**
*Qendra e enciklopedisë shqiptare e Akademisë së Studimeve Albanologjike*

## Kërkimi shkencor ndërdisiplinar - domosdoshmëri për kërkuesit e rinj shkencorë

Kërkimi shkencor ndërdisiplinar cilësohet pa dyshim në botën akademike si ndër më produktivët e më nxitësit, i cili, mes shkëmbimit dhe ndërlidhjes së njohurive prej fushave/disiplinave të ndryshme, krijon premisa për rezultate më të thelluara. Si një koncept hulumtimi, por edhe shkollimi, ai ka ofruar rezultate të spikatura dhe, në të njëjtën kohë, ka pritshmëri të larta kundrejt zbulimeve të reja, të cilat arrijnë të mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë, nëpërmjet kuptimit më të saktë e më të plotë të dukurive të saj. Sigurisht, që përpos arritjeve të konfirmuara, janë të njohura e të pranuara vështirësitë me të cilat ndeshen studiuesit në kërkimin ndërdisiplinar, sikurse janë barrierat në shkëmbimin dhe komunikimin mes instituteve tradicionale kërkimore, të ndara në bazë të disiplinave, traditë kjo që pasqyrohet edhe në organizma të tjerë profesionalë e qeveritarë. Kërkimi shkencor ka evoluar në mënyrë të pandërprerë, pavarësisht prej barrierave të disiplinave *singulare*, duke tentuar/kërkuar jo vetëm thellësi njohurish, por edhe gjerësi njohjesh e dijesh. Në dhjetëvjeçarët e fundit, me përmirësimin cilësor të njohurive dhe kërkimit shkencor, hulumtuesit e fushave të ndryshme, si teknike - ashtu edhe ato humanistike, po përballen me shtrimin dhe zgjidhjen e problemeve komplekse, të cilat kërkojnë përballje të njëkohshme/simultane, si dhe kompetenca integrale. Probleme të tilla të karakterit

selectively quoted by the neoliberal experts since the 1980s to justify the implementation of neoliberalism. Recently, social scientists, such as Thomas Piketty – whousesan interdisciplinary methodology – areprovingneoliberal policies wrong, and that they benefit the few owners of capital, not the manywho are wage-earners.

Keywords: *Utilitarianism, Neo-Liberalism, Altruism, Individualism, Society, Utopia*

**Erarba Çiraku**
*Centre of Albanian Encyclopaedia of Academy of Albanological Studies*

### Interdisciplinary research a necessity for young researchers

Interdisciplinary research is considered by the academic world as one of the most productive and encouraging pursuits, which between exchanging and linking of knowledge from various disciplines, creates premises for more accurate and advanced deliveries. As a research concept, but also as a mode of education, it has delivered remarkable results and at the same time presents high expectations for new discoveries in supporting the sustainable development of society through a more accurate and completes understanding of different phenomena. Despite the confirmed achievements, are known the difficulties faced by scholars in interdisciplinary research, such as barriers in information exchange and communication between traditional research institutes organized by disciplines, a tradition that is mirrored also to different professional and governmental institutions.

Scientific research has continually evolved beyond the boundary of singular disciplines by stressing not only the depth but also the breadth of knowledge and expertise. In recent decades researchers of various fields, both technical and humanistic, are addressing complex problems that require simultaneous confrontation as well as integral competences.

Imminent complex problems such as economic development, social inequality and the climate change issues require an interdisciplinary approach to addressing and finding sustainable solutions. The productivi-

imediat, si: zhvillimi ekonomik, pabarazia sociale, çështja e klimës, kërkojnë një adresim e ballafaqim ndërdisiplinar të kërkimit për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme. Produktiviteti dhe efektiviteti i grupeve kërkimore ndërdisiplinare është konfirmuar tashmë nga arritje të rëndësishme shkencore. Përqasja ndërdisiplinare është kuptuar dhe aplikuar nga sektori industrial privat dhe shtetëror. Në botën akademike në vendin tonë kjo lloj përqasje ka gjetur ende pak terren aplikimi, ndoshta edhe për faktin se barriera të tilla si ato të natyrës financiare, administrative, ligjore, ndikojnë negativisht në bashkëpunimin/bashkërendimin e domosdoshëm.

Në këtë kumtesë do të përqendrohemi në sfidat me të cilat përballen kërkuesit shkencor në përqasjen ndaj kërkimit ndërdisiplinar, mundësitë dhe vështirësitë që hasin institucionet akademike/studimore në fushën e kërkimit ndërdisiplinar, si dhe në disa refleksione/opinione për rrugët se si do të mundej që ato t'i tejkalojnë vështirësitë, nëpërmjet riorganizimit, rialokimit të fondeve apo programeve mësimore, për të qenë më të orientuar kah ndërdisiplinariteti. Ndërdisiplinariteti, si një metodikë para së gjithash konceptualiteti, nuk do të kuptonte kurrsesi cenimin apo relativizimin e *domenit autonomist* të disiplinave/fushave përkatëse, por nevojën që mes tyre të *shkrihen* e kapërcehen barrierat e moskomunikimeve dhe të njihet dobia dhe funksioni i tyre komplementar.

Fjalë çelës: *kërkimi shkencor ndërdisiplinar, autonomi dhe marrëdhënie e disiplinave, rrjeti i instituteve kërkimore, botime akademike, funksioni komplementar i studimeve*

**Eris Rusi**
*Akademia e të Rinjve, departamenti i gjuhës dhe i letërsisë i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë*

## Kompetencat letrare në letërsinë fantastike shqipe të shek. XX

Në kontekstin e shoqërisë bashkëkohore, të prekur nga mbizotërimi i teknikës dhe arritjeve shkencore në jetën e përditshme, ku kultura është e lidhur me efektin ekonomik që ndikon zhvillimin e saj, merr rëndësi të veçantë vlerësimi i studimeve letrare në formimin intelektual dhe qytetar të individit sot. Në këtë kontekst, përmes këtij punimi, ne do të synojmë

ty and effectiveness of interdisciplinary research groups has now been confirmed by significant scientific achievements. The interdisciplinary approach is already accepted and familiar both by private industrial sector and government. In the academic sector in our country, this approach has still little space for application, maybe, because of barriers such as: financial, administrative, legal which negatively affect the level of co-operation / co-ordination needed.

In this paper we will focus on the challenges faced by researchers in the approach to interdisciplinary research, the opportunities and difficulties faced by academic / research institutions in the field of interdisciplinary research, as well as some reflections / opinions on ways to overcome the difficulties through the reorganization, reallocation of funds or curricula, in order to be more oriented towards interdisciplinary. The interdisciplinary, as a conceptuality methodology, do not intent the violation or devaluation of the autonomous domain of singular disciplines, in contrary it aims to overcome the barriers of communications and to recognize their role and complementary functions.

Keywords: *Interdisciplinary research, autonomy and communication of disciplines, network of research institutes, academic publications, study strategy, complementary function of studies...*

**Eris Rusi**
*Albanian Young Academy. Department of Language and Literature of "Fan S. Noli " University, Korça*

## Literary competences in the albanian fantastic literature of the 20th century

In a world dominated by techniques and sciences and in a cultural dimension to its immediate economic expediency, it is likely to consider the contribution of literary studies to the intellectual and civil formation of the individual today. Through this paper we will aim to explore the dimensions of fantastic in Albanian literature, by making a general overview of the prospects of the fantastic prose and its multiple meanings in this literature.

të eksplorojmë dimensionet e fantastikes në letërsinë shqipe, duke bërë një pasqyrë të përgjithshme të perspektivave të prozës fantastike dhe kuptimeve të shumta të saj në këtë literaturë. Nga kjo rrjedh se një përgjigje e parë në pyetjen "Çfarë bën letërsia sot?", mund të dalë nga korrelacioni midis njohurisë letrare dhe vlerës së saj arsimore me nevojën për transmetim/marrjen e një metodologjie interpretuese të tekstit, që kërkon një metodë kulturore dhe didaktike. Çështjet e ngritura në këtë punim kanë prirje të mbështeten në disa koordinata të rëndësishme, si: origjina e letërsisë fantastike, kushtet, traditat historike, karakteristikat e rëndësishme, forma e saj dalluese nga llojet e tjera letrare në panoramën e krijimit fiksional; ngjashmëritë, kryqëzimet, tangjentet dhe simetritë midis fiksionit në letërsinë shqipe dhe fiksionit në prozën bashkëkohore evropiane. Përmes këtyre koordinatave, ky hulumtim do të orientohet në marrjen thelbësore të kompetencave letrare dhe kritike, duke qëndruar te interesi i fortë në cilësitë e caktuara të gjuhës letrare dhe praktikave narrative nga studiuesit e shumë disiplinave të tjera.

Fjalë çelës: *kompetenca letrare, mendimi kritik, analizë teksti, ndërmjetësim didaktik, letërsi fantastike, imagjinatë dhe fantazi.*

**Ermela Broci**
*Instituti i antropologjisë kulturore dhe studimit të artit i Akademisë së Studimeve Albanologjike*

### Përdorimi i metodave etnografike në kërkimin shkencor: avantazhe dhe disavantazhe

Etnografia është një metodë kërkimore, në të cilën studiuesi kalon një periudhë kohore në një kulturë për ta studiuar atë. Ndryshe nga metodat e tjera të hulumtimit, etnografia është pothuajse tërësisht pjesëmarrëse dhe në përgjithësi përfshin një angazhim më të madh kohor sesa hulumtimet e tjera. Pothuajse të gjitha studimet etnografike zhvillohen brenda mjediseve ku bëhet studimi, në krahasim me mjediset artificiale që krijohen për të realizuar metoda të tjera. Natyrisht, antropologët përdorin një sërë teknikash kërkimore, por në kontekst të këtij punimi, do të merret në trajtim metoda etnografike, ku hulumtuesi hyn në një

It follows that a first answer to the question "what literature does today?", can arise from the correlation between literary knowledge and its educational value with the need for transmission / acquisition of an interpretative methodology of the text that requires a cultural and didactic method.

The issues raised in this paper tend to rely on some important coordinates as:

The origins of fantastic literature, conditions, historical traditions, significant features, its distinctive shape from other literary types in the panorama of the fiction creation;

The similarities, intersections, tangents and symmetrical parallel between fiction in the Albanian literature and the contemporary European fiction.

Through this coordinates, this research will be oriented to the essential acquisition of literary and critical competence, stems from the strong interest in certain qualities of literary language and narrative practices by scholars of many other disciplines.

Key words: *Literary competences, critical thinking, text analysis, didactic mediation, fantastic literature, imaginary and imagination*

**Ermela Broci**
*Institute of Cultural Anthropology and Art Studies of the Academy of Albanological Studies*

## The ethnographic methods as a research approach; advantages and disadvantages

The ethnography is based on research methods where scholars spent a period of time to study a culture. Unlike other research methods, ethnography is almost entirely "*participant observation*" and implicates a longer commitment than other researches. Almost all ethnographic studies are conducted within the study areas compared to artificial environments created to implement the other methods. Anthropologists use a number of research techniques but the focus of this paper is the

mjedis të veçantë shoqëror, në mënyrë që të kuptojë pjesëmarrësit në thellësi, duke përfshirë vëzhgimin e tyre, intervistat dhe bisedat, me ndihmën e të cilave arrihet "zhytja" në kontekst, ndërtimi i besimit dhe raporti me agjentët.

Qëllimi i këtij punimi është të kuptohet mënyra në të cilat kjo metodë ndryshon nga metodat e tjera (pasi ato paraqesin pretendime krejtësisht të ndryshme rreth natyrës së sjelljes njerëzore dhe mënyrave për ta kuptuar atë), si dhe të përshkruajë disa nga karakteristikat më të rëndësishme të kësaj metode, duke treguar se si në çdo metodë kërkimore edhe rasti i asaj etnografike ka avantazhet dhe disavantazhet e veta.

Fjalët kyçe: *etnografia, metoda, hulumtimi në terren, hulumtimi cilësor, vëzhgimi me pjesëmarrje*

**Ervin Hoxha[1], Etleva Hamzaraj[2]**
*[1]Departamenti i Bioteknologjisë i Universitetit të Tiranës, [2]departamenti i biologjisë i Universitetit të Tiranës*

## Vlerësimi i marrëdhënies mes parametrave fiziko-kimikë dhe atyre mikrobiologjikë në studimin e cilësisë së ujit në komunat e qarkut Fier

Njerëzit janë vazhdimisht të shqetësuar për cilësinë dhe sigurinë e ujit të pijshëm. Sigurimi i kësaj cilësie është një ndër sfidat më të mëdha me të cilat po përballet Shqipëria së fundmi. Qëllimi i këtij studimi është të përcaktohet në mënyrë të plotë cilësia e ujit të pijshëm, bazuar në indikatorët mikrobiologjikë në njësitë administrative të bashkisë Fier, si dhe të analizohet një lidhje e mundshme midis parametrave kimiko-fizike dhe pranisë së indikatorëve mikrobiologjikë. Studimi përfshin një periudhë prej gushtit 2013 deri në nëntor 2014. Gjatë kësaj periudhe kohore janë mbledhur mostra për çdo muaj, në 31 pika të ndryshme monitorimi në të 13 njësitë administrative të bashkisë Fier dhe janë analizuar gjithsej 478 mostra. Për përcaktimin e pranisë së *Escherichia coli*-t është përdorur indeksi MPN, ndërsa për përcaktimin e baktereve heterotrofike është përdorur metoda e numërimit të kolonive në

ethnographic method of "participant observation", where the researcher enters and participates in a particular social environment through the conversations and interviews in order to build the confidence and good relation with the agents.

The aim of this paper is to understand how this method is different and to describe some of the most important features of this, focusing on its advantages and disadvantages.

Keywords; *ethnography, method, research in terrain, qualitative research, participant observation*

**Ervin Hoxha[1], Etleva Hamzaraj[2]**
*[1]Department of Biotechnology of University of Tirana. [2]Department of Biology of University of Tirana*

## Evaluating the relationship between physico-chemical and microbiological parameters in the water quality study in the Fier Region communes

People are constantly concerned about the quality and safety of drinking water. Ensuring this quality is one of the biggest challenges that Albania is facing lately. The purpose of this study is to fully determine the quality of drinking water, based on the microbiological indicators in Fier municipality administrative units, and to analyze a possible link between physical chemistry parameters and the presence of microbiological indicators. The study includes a period from August 2013 to November 2014. During this time period, samples were collected for each month, in 31 different monitoring points in 13 municipal administrative units of Fier and a total of 478 samples were analyzed. For determining the presence of Escherichia coli, the MPN index was used, whereas for the determination of heterotrophic bacteria the colon counting method on PCA plates was used. According to preliminary data in most of the analyzed samples, there is no presence of fecal indicators except in 8% of cases that resulted positive for at least one indicator such as E. coli.

Keywords: *physicochemical parameters, MPN index, fecal indicators, level of contamination.*

pjatat me PCA. Sipas të dhënave paraprake, në shumicën e mostrave të analizuara nuk ka prani të indikatorëve fekalë, përveçse në 8 % të rasteve që rezultuan pozitive për të paktën një indikator si *E.coli*.

Fjalë çelës: *parametra fiziko-kimikë, indeksi MPN, indikatorë fekalë, niveli i ndotjes*

**Flamur Maloku**
*Departamenti i gazetarisë i Universitetit të Prishtinës, Kosovë*

### Letërsia e burgut përballë faktit dhe fiksionit

Letërsia e burgut, si shenjëzim faktual dhe fiksional njëkohësisht, ruan specifikat e veta, të cilat lidhen me rrethanat e krijimit të saj. Duke qenë se kjo lloj letërsie përbën një rast të veçantë në letrat shqipe dhe nuk është fort e studiuar, shtysa për t'u marrë me të na vë përpara sfidash të natyrave të ndryshme, në përpjekjen për të dhënë një përkufizim mbi atë se çfarë është "letërsia e burgut" në vetvete, fiksion apo fakt. Një argumentim i këtillë kërkon, para së gjithash, edhe mendime teorike, për një venerim sa më të saktë të përballjes së ndodhive reale si fakt me përjetimet autoriale si fiksion, e dëftuar tashmë në letrat shqipe me shkrimet dhe autorët e saj, ku letërsia ishte bërë hapësirë lirie, madje diçka më shumë, forcë mbijetese dhe fuqi shprehëse.

Fjalë çelës: l*etërsi e burgut, rrethana krijuese, liri, fiksion, fakt*

**Helena Lubonja[1], Aida Zoto[2]**
*[1]Kërkuese e pavarur, [2]departamenti menaxhim-turizëm i Kolegjit Universitar "Logos", Tiranë*

### Studimi i tipareve morfo-sintaksore dhe leksikore të fëmijëve shqip- dhe greqishtfolës, përmes metodave të reja kërkimore (Testi i Përsëritjes së Fjalive dhe Testi Matës i Fjalorit)

Qëllimi i këtij studimi kërkimor është të zbuluarit dhe të kuptuarit e hapave zhvillimorë të tipareve morfo-sintaksore të fëmijëve bilingualë

**Flamur Maloku**
*Department of Journalism of the University of Pristina, Kosova*

## Prison literature versus fact and fiction

Preliminary literature, both factual and fictional at the same time, preserves its own specifics which relate to the circumstances of its creation. Since this kind of literature constitutes a special case in Albanian letters and is not well studied, pushing to deal with it puts us ahead of challenges of different nature in trying to give a definition of what it is Preliminary Literature in itself, is it fiction or fact. Such argumentation requires theoretical thoughts for a more accurate observation of the real events as facts, with the authorial experiences as fiction, already shown in Albanian writings and its authors where literature had become a space of freedom. Moreover, a survival force and expressive power.

*Key words: Fact, fiction, theoretical perspectives, freedom of expression*

**Helena Lubonja[1], Aida Zoto[2]**
*[1]Independent Researchers. [2]Department of Tourism Management of University College "Logos", Tirana*

## Study of morphosyntactic and lexical features of Albanian and Greek speaking children through new research methods (Sentence Imitation Test and Word Finding Vocabulary Test)

Modern scientific research is the process of revealing scientific truth through adherence to new, modern scientific methods. Scientific inquiry is a process which consists of the investigation and the processing of research data, the discovery of new facts and advances in knowledge in the involved field of study.

The purpose of this research study is to discover and to understand the developmental phases of morphosyntactic features and to perform the quantitative and qualitative evaluation and analysis of lexical features within bilingual children aged 6-12.

të moshave 6-12 vjeç, sikurse dhe vlerësimi e analiza sasiore e cilësore e tipareve leksikore të tyre.

Testi i Përsëritjes së Fjalive u hartua në shqip nga E. Kapia dhe A. Kananaj në kuadrin e projektit panevropian mbi shumëgjuhësinë Cost Action ISO804 "Language Impairment in a Multilingual Society: Linguistics Patterns and the Road to Assessment", duke marrë parasysh strukturat sintaksore të shqipes, si edhe zhvillimin e tyre në gjuhën e fëmijëve qysh në lindje. Metodologjia e përdorur në këtë studim është ajo e anketimit të fëmijëve përmes përsëritjes së fjalive, e ndërtuar si një lojë kompjuterike. Pas kërkimesh të shumta rreth marrëdhënies midis kujtesës verbale afatshkurtër dhe gjuhës tek fëmijët me zhvillim normal si edhe tek fëmijët me probleme në të folur, u konstatua një lidhje e drejtpërdrejtë midis aftësisë së fëmijëve për të përsëritur fjalë dhe fjali dhe aftësive të tyre gjuhësore.

Testi Matës i Fjalorit u hartua në kuadrin e projektit mbi bilingualizmin "Thalis Project, Bilingual Acquisition & Bilingual Education: The Development of Linguistic & Cognitive, Abilities in Different Types of Bilingualism", I.Tsimpli. U përkthye dhe u përshtat në shqip nga E. Kapia dhe u zhvillua tek fëmijët me zhvillim normal mendor dhe fizik, në mënyrë që të përcaktohej niveli i fjalorit matës të tyre. Ky test, si një mjet vlerësimi gjuhësor i besueshëm, mundëson matjen e saktë të aftësive leksikore të fëmijëve. Mjetet matëse apologjike të përcaktuara në gjuhën shqipe i ndihmojnë studiuesit dhe profesionistët për të kuptuar rrjedhën e zhvillimit të gjuhës tek fëmijët shqiptarë, por dhe kuptimin dhe përcaktimin e patologjive gjuhësore në gjuhën shqipe.

Në përfundim të këtij studimi do të paraqiten shkurtimisht rezultatet e matjeve gjuhësore të Testit të Përsëritjes së Fjalive sipas tipit të bilingualizmit dhe gjinisë, sikurse dhe normat krahasuese të përgjigjeve të Testit Matës të Fjalorit midis bilingualëve dhe monolingualëve dhe rezultatet sipas gjinisë.

Fjalë çelës: *metoda të reja kërkimore, bilingualizmi, Testi i Përsëritjes së Fjalive, Testi Matës i Fjalorit*

The Sentence Imitation Test used throughout this study was drafted in Albanian under the pan-European Eurocores Project on Multilingualism - Cost Action ISO804 "Language Impairment in a Multilingual Society: Linguistic Patterns and the Road to Assessment" by E. Kapia and A. Kananaj, by taking into account the *syntactic structures* of the Albanian language and their development in children's language since birth. The methodology used in this study - brought as a novelty - consists of a computer game designed to survey children through the use of recurring sentences and words. After extensive research about the relationship between short-term verbal memory and language, within children with normal development and children with speech problems, a direct link was found between the ability of children to repeat words and sentences and their linguistic skills.

The Word Finding Vocabulary Test was drafted under the "Thalis Project, Bilingual Acquisition & Bilingual Education: The Development of Linguistic & Cognitive, Abilities in Different Types of Bilingualism" (I. Tsimpli), a project on bilingualism, and was translated and adapted in Albanian by E. Kapia. This test, as a reliable linguistic evaluation tool which enables accurate measurement of children's lexicon capabilities, was conducted on children with normal mental and physical development in order to assess the level of their vocabulary. The apologetic measuring tools defined in the Albanian language, offer significant help to researchers and professionals to understand the course of language development in Albanian children, and the definition of language pathologies within the Albanian language.

At the end of this study, the results of the linguistic measurements of the Sentence Imitation Test as per the type of bilingualism and gender and the comparative rates of the answers between bilingual and monolingual children and their gender based on the Word Finding Vocabulary Test will be presented.

Keywords: *new research methods, bilingualism, Sentence Imitation Test, Word Finding Vocabulary Test*

**Ilda Kazani[1,2], Albana Halili[1,3], Elma Zanaj[4], Aulon Shabani[5], Majlinda Hylli[2]**
*[1]Akademia e të Rinjve, [2]departamenti i tekstilit dhe modës i Universitetit Politeknik i Tiranës, [3]departamenti i teknologjisë së informacionit i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, [4]departamenti i elektronikës dhe telekomunikacionit i Universitetit Politeknik të Tiranës*

## Tekstilet inteligjente sjellin së bashku hulumtues të fushave të ndryshme disiplinore

Gjatë viteve të fundit, kombinimi i materialeve tekstile me elemente elektronike na ka prezantuar me "tekstile të zgjuara/ inteligjente" ose "veshjet elektronike". Përtej inxhinierisë së tekstilit, këto produkte të reja kërkojnë një kualifikim më të gjerë, pasi këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me një teknologji tradicionale, por me një ndërthurje të teknologjive. Për më tepër, bëhet edhe më e ndërlikuar kur, për shembull, nga një veshje kërkohet monitorimi i funksioneve jetësore. Në raste të tilla është i domosdoshëm kontributi i grupeve të ndryshme, të cilët kanë kualifikime të ndryshme, si stilistë, inxhinierë, kimistë dhe mjekë. Së bashku ata mund të kontribuojnë në zhvillimin e aplikimeve të ndryshme, si për ushtrinë, zjarrfikësit dhe përgjegjësit e parë, si dhe ndaj veshjeve mjekësore dhe atyre të rastit. Në varësi të qëllimit të aplikimit, ata mund të kenë qasje të ndryshme ndërdisiplinore, në mënyrë që të kenë një zhvillim të suksesshëm të prototipit.

Sfida për hulumtuesit në fushën e tekstilit është që të bëjë sa më shumë elemente që të jetë e mundur prej materialeve të tekstilit. Në këtë artikull do të paraqiten pesë projekte nga Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT), të cilat janë realizuar në bazë të hulumtimeve ndërdisiplinore. Projekti i parë paraqet dy aplikime të mundshme: së pari, një biosensor tekstili i stampuar me shabllon, për kujdesin ndaj shëndetit dhe, së dyti, një antenë tekstili e stampuar me shabllon, për komunikim të jashtëm. Projekti i dytë paraqet një triko "të zgjuar" për një rehati më të mirë në një klimë të ftohtë. Projekti i tretë paraqet një lëkurë përçuese të elektricitetit, për aplikime të ndryshme të zgjuara. Projekti i katërt paraqet një fije përçuese të elektricitetit, nëpërmjet teknologjisë së elektrofilaturimit, për aplikime në tekstilet e zgjuara. Projekti i fundit është "Teknologjitë e jetesës në ambientet e kontrolluara

**Ilda Kazani[1,2], Albana Halili[1,3], Elma Zanaj[4], Aulon Shabani[5], Majlinda Hylli[2]**
*[1]Albanian Young Academy. [2]Department of Textile and Fashion of Polytechnic University of Tirana. [3]Department of Information Technology of University "Aleksander Moisiu" of Durres. [4]Department of Electronics and Telecommunications of Polytechnic University of Tirana.*

**Smart textiles bring together multidisciplinary researchers**

Over the last years, the combination of textiles with electronics has introduced the so called 'smart/intelligent textiles' or 'wearable electronics'. In addition to textile engineering, these novel products ask for a wider background, since here we are not dealing only with a traditional technology but with a combination of technologies. Furthermore, it's getting even more complicated when, for instance, the monitoring of human vital signs from a garment is required. In such cases, the contribution of different research groups with various backgrounds such as designers, engineers, chemists and medical doctors is utterly required. Altogether they can contribute to the development of various applications ranging from those used by the military, the fire-fighters and the first responders to the ones used for medical garments and casual garments as well. Depending on the aim of the application, there is a need of different interdisciplinary approaches in order to have successful prototype developments. Nowadays, making as many components as possible out of the available textile materials is the challenge of textile researchers. Recently, Albanian researchers have made certain developments in this field as a result of both national and international collaborations. These groups have started working in this area for almost one decade, and successful results have been obtained. Five cases of research conducted by the research groups in Polytechnic University of Tirana (PUT), will be mentioned in this paper. The first one is related to the use of screen printed textiles for health care biosensor applications and antenna for off-body communication. The second case of research was done to produce a smart sweater for better comfort in a cold climate. A third application is the production of conductive leather for various smart uses. Another case of ongoing research from our collaborative group is related to an electrospun electroconductive yarn, to be used for smart textile applications. And finally, the last application, which will be mentioned, is on 'Ambient Assisted Living Technologies for monitoring elderly people', in

për monitorimin e personave të moshuar", duke përmirësuar kështu kushtet e shëndetit dhe mirëqenien e tyre. Për të gjitha aplikimet, ishte shumë i rëndësishëm një bashkëpunim mes kimistëve, inxhinierëve të tekstilit, inxhinierëve elektrike dhe elektronikë

Fjalë çelës: *tekstile, elektronike, tekstile të zgjuara/inteligjente, multidisiplinar.*

**Nereida Malo[1], Amilda Ballata[1], Sonila Vito[1], Dhurata Premti,[1] Majlinda Vasjari[2], Rozana Troja[1]**
*[1]Departamenti i kimisë industriale i Universitetit të Tiranës, [2]departamenti i kimisë i Universitetit të Tiranës*

### Përdorimi i burimeve të hapura të edukimit në shkencën e ushqimit

Koncepti i Burimeve të Hapura të Edukimit (OER) në thelb ka të bëjë me çdo burim edukimi (përfshirë këtu tekste, video të disponueshme online, aplikacione të ndryshme apo edhe çdo material tjetër që është projektuar për përdorim në procesin e mësimdhënies), që vihet në përdorim nga studentët apo mësimdhënësit. Siguria ushqimore lidhet me të gjitha rrisqet kronike apo akute, që prekin shëndetin e njeriut. Informacioni lidhur me këtë çështje në departamentin e kimisë industriale, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, është i organizuar nëpërmjet leksioneve, seminareve, punës praktike në laborator, projekteve të ndryshme etj. Në aspektin praktik, produktet ushqimore analizohen bazuar në karakteristikat fiziko-kimike, ngarkesat mikrobiale, studimin taksonomik të mikroorganizmave, si edhe eksplorimin e mikroorganizmave ndotës nga mjedisi. Interesi në këtë fushë në të ardhmen konsiston në mundësinë e përdorimit të leksioneve apo punës kërkimore online, në implementimin e metodave instrumentale nëpërmjet OER-it për përcaktimin e përbërësve specifikë në produkte ushqimore. Duke iu referuar analizës mikrobiologjike, është me mjaft interes shfrytëzimi i burimeve të hapura të edukimit me qëllim: identifikimin dhe karakterizimin e mikroorganizmave nëpërmjet përdorimit të metodave të biologjisë molekulare, identifikimin e avanta-

order to improve their safe health conditions and wellness. For all the above-mentioned applications, multidisciplinary collaboration between chemists, textile, electrical and electronic engineers has been very important and it has resulted in very efficient works.

Keywords: *textile, electronics, smart/intelligent textiles, multidisciplinary.*

**Nereida Malo[1], Amilda Ballata[1], Sonila Vito[1], Dhurata Premti,[1] Majlinda Vasjari[2], Rozana Troja[1]**
*[1]Department of Industrial Chemistry of University of Tirana. [2]Department of Chemistry of University of Tirana*

**Open educational resources in food science**

The concept of Open Educational Resources (OER) comprises any educational resources (including course materials, textbooks, streaming videos, multimedia applications, podcasts, and any other materials that have been designed for use in teaching and learning) that are openly available for use by teachers and students. Food safety refers to all those hazards, whether chronic or acute, that may make food injurious to the consumer's health. The information about food safety and quality at the Department of Industrial Chemistry, Faculty of Natural Sciences is organized in lectures, seminars and exercises, laboratory practices, etc. In the practical aspect, food is analyzed referring to the physical-chemical properties and microbiological aspects, which include microbial charges, taxonomic studies of microorganisms and exploration of environmental microbial pollution. Future interests in food analysis consist in the possibility to access lectures and research works on food processing online, as well as the implementation of OER for instrumental methods of analysis in the determination of specific components of food. Referring to the microbiological aspect, it is useful to characterize and to identify microorganisms using molecular methods. It is also important to identify the advantages and the disadvantages of using molecular-based methods as compared to classical ones, as well as the use of instrumental methods in order to determine bio molecules derived from specific microorganisms.

zheve dhe disavantazheve të metodave molekulare me ato klasike dhe, gjithashtu, përdorimi i metodave instrumentale të analizës në përcaktimin e biomolekulave të derivuara nga mikroorganizma specifike etj.

Fjalë çelës: *burime të hapura të edukimit, siguria dhe cilësia ushqimore, metoda instrumentale të analizës, identifikimi i mikroorganizmave*

**Mentor Beqa**
*Akademia e të Rinjve, fakulteti i shkencave politike-juridike i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës*

**Raporti ndërmjet historisë dhe shkencave sociale: a mund të jetë shpjegimi historik teorikisht neutral?**

Fenomeni që merret në shqyrtim në këtë artikull është prirja që shkencat sociale në Shqipëri të mbeten gjithnjë e më johistorike, ndërsa, nga ana tjetër, historia të mbetet një disiplinë e mbyllur në vetvete. Marrëdhënia ndërmjet shkencave sociale (sociologji, antropologji, shkenca politike etj.) dhe historisë si disiplinë është një proces kompleks edhe në nivel global, por debati epistemologjik për dialogimin ndërmjet tyre është i pranishëm prej më shumë se një shekulli. E veçanta e rastit të studimeve shqiptare është fakti se nuk është shtruar asnjëherë seriozisht një debat i hapur brenda komunitetit akademik se cili duhet të jetë në pikëpamje epistemologjike dhe metodologjike raporti ndërmjet historisë dhe shkencave sociale. Në pjesën e parë, artikulli rishikon literaturën mbi këto zhvillime në nivel ndërkombëtar. Në pjesën e dytë shqyrtohet literatura e pakët që e trajton këtë çështje nga perspektiva e studimeve shqiptare. Ndërsa në pjesën e tretë, do të përqendrohemi tek fakti se si objekti historik merr tjetër kuptimësi kur trajtohet mbështetur mbi premisa të ndryshme teorike dhe metodologjike, duke u fokusuar në veçanti tek disiplina e Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Artikulli mbërrin në përfundimin se asnjë shpjegim nuk mund të jetë neutral në pikëpamje teorike, prandaj nxit përdorimin sistematik të teorive dhe metodave të shkencave sociale në shqyrtimin e fenomenit historik.

Fjalë çelës: *historia, shkencat sociale, epistemologjia, debat, studime shqiptare, objekt historik, marrëdhënieve ndërkombëtare*

Keywords: *OER, food safety and quality, instrumental methods of analyses, identification of microorganisms*

**Mentor Beqa**
*Albanian Young Academy. Faculty of Juridical and Political Science of University "Aleksandër Moisiu", Durrës*

**The relationship between History and Social Science: Can historical explanation be theoretically neutral?**

This paper analyzes the tendency of social sciences in Albania to remain as ahistorical as possible, while on the other hand the history becomes more and more self-contained. The relationship between social sciences and history as a discipline is a complex process even at a global level, but the epistemological debate about the dialogue between them has been present for more than a century. What makes the Albanian studies a special case, is the fact that there has never been an open debate within the academic community about the relationship that history and social sciences should have on epistemological and methodological terms. In the first part of the paper, there is the literature review addressing this issue at global level. In the second part, we analyze the limited literature addressing this issue from the perspective of the Albanian studies. In the third part of the paper we concentrate on how the historical object acquires different meanings when it is analyzed within different theoretical and methodological paradigms, focusing especially on the discipline of International Relations. This paper concludes that there is no way that historical explanation could be theoretically neutral, therefore encouraging the systematic use of theories and methods of social sciences to explain the historical phenomena.

Keywords: *history, social sciences, epistemology, debate, Albanian studies, historical object, internacional relations*

**Mikaela Minga**
*Akademia e të Rinjve, instituti i antropologjisë kulturore dhe studimit të artit i Akademisë së Studimeve Albanologjike*

## Etnomuzikologjia dhe kënga urbane në Shqipëri

Dukuritë muzikore urbane kanë zënë një vend të reduktuar në traditën e studimeve në Shqipëri. Duke filluar nga vitet '50, kohë kur u institucionalizuan disiplina të tilla si etnomuzikologjia dhe muzikologjia, studiuesit treguan një interes të posaçëm për praktikat muzikore të zonave rurale. Krahas interesit studimor, këto konsideroheshin edhe si bartëse të "autenticitetit" dhe "pastërtisë" së nevojshme, për të identifikuar, nëpërmjet tyre, përkatësitë dhe cilësitë kombëtare të kësaj kulture muzikore. Përkundër, muzika e qytetit kishte një reputacion të dyshimtë, për shkak të natyrës së saj hibride dhe ndikimeve të ardhura nga jashtë. Në vitet e fundit, është vënë re një interes ndaj dukurive muzikore të qytetit, të trajtuara qoftë nga një qasje historiografike, etnografike, qoftë edhe analitike.

Nëpërmjet studimit të një gjinie muzikore urbane, siç është kënga korçare, do të përpiqemi të sjellim në vëmendje disa aspekte nga metodat e kërkimit në terren, në kontekstin urban, në kuadër të etnomuzikologjisë urbane, një degëzim i rëndësishëm tanimë brenda disiplinës kryesore: etnomuzikologjisë. Nga ana tjetër, kushtet historike në të cilat ishte zhvilluar kënga korçare, sidomos në gjysmën e dytë të shekullit XX, e karakterizuar, ndër të tjera, nga mungesa e madhe e atyre që konsiderohen si të dhëna primare e arkivore, çuan në ndjekjen e shtigjeve të reja të kërkimit. Këto të fundit sollën një qasje tjetër ndaj lëndës në fjalë, gjë që u reflektua, rrjedhimisht, edhe në rezultatet e kërkimit.

Fjalë çelës: *kënga urbane, qyteti, kultura shqiptare, etnomuzikologjia, oraliteti, regjistrimet zanore*

**Odeta Manahasa**
*Departamenti i arkitekturës i Universitetit "Epoka", Tiranë*

## Dija nëpërmjet shikimit, shikimi nëpërmjet dijes

Është një fakt i qëndrueshëm dhe i pranuar se forma me shumë kuptimet e saj është e lidhur me procesin e të shikuarit. Për më tepër,

**Mikaela Minga**
*Albanian Young Academy. Institute of Cultural Anthropology and Art Studies of the Academy of Albanological Studies*

### Ethnomusicology and the urban song in Albania

Music studies in urban areas have been less developed in Albania in comparison to rural contexts. The latter were considered also as more 'authentic' and 'archaic' for the national-oriented approach that ethnomusicology had. The urban musical practices were more hybrid and therefore lacked such 'authenticity'. This perspective has been dominant from the '50s and only recently the city and its urban culture have come to the fore. This concerned not only ethnomusicology but also anthropology and ethnography.

A specific urban genre, Korça's song will be the case study for discussing such perspective. Furthermore, the way this song developed during the second half of the century was characterized by a lack of what are considered primary research sources. This situation oriented the research on Korça's song towards new directions that are going to be adressed as well in the paper.

Key words: *urban song, city, Albanian culture, ethnomusicology, orality, registrations*

**Odeta Manahasa**
*Department of Architecture of Epoka University, Tirana*

### Knowing through seeing, seeing through knowing

Shape ambiguity and its relation to the process of seeing is a consistent and accepted fact. Furthermore, is acknowledged that this ambiguity is reflected between seeing and knowing. The examination of the role of considered basic geometrical shapes as Fundierung of static knowledge and the dynamism of seeing as Fundierung in the process of creative design is how this research initiated. Focusing particularly on the painting of Pablo Picasso "Ma Jolie" given as a basic design 2D exercise to architec-

pranohet se fitimi i më shumë se dy kuptimeve të formës pasqyrohet qartazi midis të shikuarit dhe dijes. Ekzaminimi i rolit të formave gjeometrike bazë, të konsideruara si *Fundierung*-u i dijeve të konfirmuara (static knowledge), si dhe studimi i dinamikës së shikimit si *Fundierung* është pikënisja e këtij hulumtimi. Duke u ndalur në pikturën e Pablo Picasso-s "Ma Jolie", e dhënë si një ushtrim fillestar në kompozimet dydimensionale studentëve të arkitekturës, ky punim do të përpiqet të japë një pikëpamje kritike mbi fuqinë e imazheve, të cilat janë mjet dijeje dhe që u japin liri hartuesve të mendimit. S*hape grammar* (gramatika e formës) dhe *computation* (procedim njohurie) në skema të ndryshme, janë dy mjete të cilat përdoren nga ky hulumtim për të integruar llogaritjen në fushat e dizajnit. Skemat janë një version i përgjithshëm i rregullave që ndihmojnë në diskutimin e vendimeve të dizajnit. Ky studim fokusohet në mënyrë specifike në atë se si nxënësit përdorin gjuhën formale për të analizuar pikturën "Ma Jolie".

Një kërkim në veprim dhe një metodë e tillë formale, përveç qëllimeve të mësimdhënies, formon aftësitë e nxënësve për të lidhur forma të ndryshme në nivele të ndryshme të kompleksitetit. Diskutimi do të bazohet në fushën e të kuptuarit në bazë të njohurive, për të kontribuuar në mendimin krijues të përpjekjes për të thyer mënyrën konvencionale të të kuptuarit.

Fjalët çelës: të shikuarit, *fundierung,* dizajn kreativ, dije, formë

**Rigers Bakiu**
*Akademia e të Rinjve, departamenti i akuakulturës dhe peshkimit i Universitetit Bujqësor të Tiranës*

## Metodologjia në projekte të kërkimit shkencor praktik për mbrojtjen e specieve detare në rrezik

Deti Mesdhe përfaqëson një qendër të rëndësishme biodiversiteti, ku rreth 17000 specie detare jetojnë në të. Biodiversiteti është gjithashtu më i lartë në zonat bregdetare dhe kufijtë kontinentalë, ku ulje e konsiderueshme e tij ndodh me rritjen e thellësisë. Trendi në kohë tregon se mbishfrytëzimi dhe humbja e habitateve ka qenë shkaku i gjithë ndryshimeve historike në biodiversitet. Aktualisht, humbja e habitatit dhe degradimi, i ndjekur nga impakti i peshkimit, ndotja, ndryshimet klimaterike, eutrofikimi dhe ardhja e specieve të huaja/invazive janë

tural students, this paper will try to give a critical view on the power of images as a tool for knowledge and as a tool that gives freedom to design thinkers. Both shape grammar and computation in different schemas are tools used in this research to bring calculation in the design fields. Schemas are a general version of rules which are helpful in discussing design decisions. This study specifically focuses on how students make use of formal language to analyze "Ma Jolie" painting. Such an action research and a formal method beside teaching purposes, shapes student's abilities to relate various forms at different levels of complexity. The discussion will be grounded in the domain of seeing based on knowledge in order to contribute to the creative thought of trying to break the conventional way of seeing.

Keywords: *seeing, fundierung, creative design, knowledge, shape*

**Rigers Bakiu**
*Albanian Young Academy. Department of Aquaculture and Fisheries of Agricultural University of Tirana*

## Methodology for Practical Research to Protect the Marine Species at Risk of Extinction

The Mediterranean Sea is a marine biodiversity hot spot, where approximately 17000 marine species occurring in it. Biodiversity is also generally higher in coastal areas and continental shelves, and decreases with depth. Temporal trends indicate that overexploitation and habitat loss have been the main human drivers of historical changes in biodiversity. At present, habitat loss and degradation, followed by fishing impacts, pollution, climate change, eutrophication, and the establishment of alien species are the most important threats and affect the greatest number of taxonomic groups. All these impacts are expected to grow in importance in the future, especially climate change and habitat degradation. Many species are gradually becoming endangered or critically endangered (at risk of extinction), where some of the most threatened chondrichthyan (skates, rays and sharks) populations in the world are still present in it.

rreziqet më të rëndësishme dhe ndikojnë ndaj pjesës më të madhe të grupeve taksonomike. Mendohet se gjithë këto efekte do të rriten për nga rëndësia në të ardhmen, ku në veçanti përfaqësohen nga ndryshimet klimaterike dhe degradimi i habitatit. Shumë specie janë duke u transformuar gradualisht në specie të rrezikuara nga zhdukja, ku disa prej peshqve kërcorë (rajat, peshkaqenët dhe peshqit kitarë) më të rrezikuar në gjithë globin janë ende të pranishëm në të. Për shembull, në veri të detit Jon, zbarkimet e peshkaqenëve blu pësuan rënie 74% në abondancë dhe 83% në biomasë në 20 vitet e fundit (Shqipëri dhe Sicili). Një projekt i titulluar "Fillimi i mbrojtjes së peshkaqenëve në ujërat territoriale shqiptare duke realizuar ekspedita në peshkim dhe ndërgjegjësim në komunitet" është duke u implementuar dhe metodologjia përkatëse do të përfaqësojë një shembull të metodologjive të përdorura në projekte të ngjashme për të realizuar një kërkim shkencor praktik në mënyrë që të propozohen dhe të vihen në praktikë masat e duhura për mbrojtjen e tyre nga zhdukja.

Fjalët çelës: *biodiversiteti, speciet e rrezikuara, peshkaqenët, ekspedita peshkimi, ndërgjegjësimi i komunitetit*

**Sami Behrami[1], Fadil Bajraktari[2]**
*[1]Kolegji universitar "Pjetër Budi", Prishtinë, Kosovë, [2]Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës*

## Metodat bashkëkohore hartografike në hulumtimet demografike

Temë trajtimi në këtë punim do të jetë paraqitja hartografike e karakteristikave demografike dhe përpjekjet për unifikimin e të dhënave demografike drejt krijimit të Sistemit Informativ Demografik - SID (demographic information system--DIS).

Karakteristikat demografike paraqesin pjesën më dinamike të gjeo-hapësirës. Paraqitja hartografike e karakteristikave demografike të një gjeo-hapësirë të caktuar ka përparësi të shumta krahasuar me format e tjera, siç janë: forma tekstuale ose e treguesve numerikë për faktin se ato ofrojnë informacion të shpejtë dhe më gjithëpërfshirës (të plotë).

Paraqitja hartografike e treguesve demografikë u mundëson përdoruesve që më shpejt dhe më saktë të arrijnë te rezultatet dhe analiza të ndryshme demografike të niveleve të ndryshme. Me këtë rast

For example, in the northern Ionian Sea, landings of blue shark declined by 74% in abundance and 83% in biomass over 20 years (Albania and Sicily). A Project entitled "Beginning of Sharks Conservation in Albanian Territorial Waters by Performing Fisheries Survey and Sensitizing Communities" is still ongoing and its methodology will represent an example of the methodologies used in similar project for doing practical research in order to propose and put into practice appropriate actions for their conservation.

Keywords: *biodiversity; endangered species; sharks; fisheries survey; sensitizing community*

**Sami Behrami[1], Fadil Bajraktari[2]**
*[1]University College "Pjeter Budi" Prishtina, Kosova. [2]Kosovo Agency for Environment Protection*

### Contemporary mapping methods in demographic research

The topic of this project is the mapping of demographic characteristics, and the efforts to unify demographic data to build Demographic Information System - DIS.

Demographic characteristics present the most dynamic part of the geo-area. To present demographic characteristics in a assigned geo – area has more advantages compared with other forms, like textual form, or numeric indicators. It offers faster and more comprehensive information.

Demographic indicators in mapping are more useful for users to get faster different results and analysis at different levels. In this case, different problems appear, and the stage of collecting and processing data is more fundamental.

This problem has greatly facilitated various specialized organizations in the field of demography by creating unique methodologies in collecting, processing, and publication of demographic data (open and free data bases), while the next step is unifying the methodology for analyzing demographic indicators.

paraqiten edhe probleme të ndryshme, prej të cilave më fondamentalja është etapa e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave.

Këtë problematikë në masë të konsiderueshme e kanë lehtësuar organizatat e ndryshme të specializuara të fushës së demografisë, duke krijuar metodologji unike në mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe publikimin e të dhënave për popullsinë (baza të të dhëna të hapura dhe pa pagesë për përdorim), ndërsa hapi i ardhshëm është unifikimi i metodologjisë për analizën e treguesve demografikë. Së bashku me GIS-n, këto baza të të dhënave kanë mundësuar shpejtësi dhe saktësi të madhe në prezantimin e treguesve demografikë, specialistëve dhe opinionit të gjerë për problemet demografike.

Në të njëjtën kohë organizata të shumta kombëtare dhe ndërkombëtare janë duke punuar për standardizimin e të dhënave demografike dhe ngritjen e një sistemi të veçantë të bazave të të dhënave demografike, duke ngritur Sistemin Informativ Demografik - SID, i cili paraqet një regjistër kombëtar të kompjuterizuar, i cili përmban informata bazë për popullsinë dhe strukturat e një shteti.

Ndërlidhja në mes Sistemit Informativ Gjeografik - GIS dhe Sistemit Informativ Demografik - DIS mundëson: krijimin e një sërë modelesh të cilat shprehin dallimet; përdorimin e metodave më të përshtatshme për prezantimin e trendit dhe perspektivën e veçorive demografike të një zone të caktuar; klasifikimin e zonave sipas prirjeve të zhvillimit demografik; nxjerrjen e rekomandimeve më të sakta për zhvillimet në të ardhmen dhe modelin më të përshtatshëm për zhvillimin e qëndrueshëm demografik në të ardhmen.

Fjalë çelës: *popullsia, baza e të dhënave, hartografike, demografike, GIS, SID.*

**Sonila Vito[1], Dhurata Premti[1], Nereida Malo[1], Amilda Ballata[1], Majlinda Vasjari[2], Rozana Troja[1]**
*[1]Departamenti i kimisë industriale i Universitetit të Tiranës; [2]departamenti i kimisë i Universitetit të Tiranës*

### Zbatimi i OER-it gjatë procesit mësimor

Në këtë studim paraqitet ideja e përdorimit të burimeve të hapura mësimdhënëse (OER) për të rritur cilësinë e mësimdhënies në lëndë,

Together with GIS, these data bases have provided higher speed and precision in the demographic presentation of indicators, for the specialists and for the public regarding the demographic problems.

At the same time, a lot of national and international organizations are working to have standard demographic data, and to create a specific data base for demographic data building Demographic Information System – SID. It will represent a national computerized register which includes basic information for demography and the structure of population in a state.

The interconnection between the Geographic Information System - GIS and the Demographic Information System - DIS will enable: the creation of several models that express the differences; the use of the most appropriate methods for presenting the trend and the perspective of the demographic characteristics of a given area; the classification of areas according to demographic development trends; more accurate recommendations for future developments, and the most appropriate model for the sustainable demographic development in the future.

Keywords: *demography, data base, mapping, GIS, SID*.

**Sonila Vito[1], Dhurata Premti[1], Nereida Malo[1], Amilda Ballata[1], Majlinda Vasjari[2], Rozana Troja[1]**
*[1]Department of Industrial Chemistry of University of Tirana. [2]Department of Chemistry of University of Tirana*

### Implementing OER in teaching

This paper introduces the idea of using Open Educational Resources (OER) to increase the teaching quality in subjects like Wastewater Treatment Technologies and Simulation in Chemical Engineering. Current market demands related to waste water treatment technologies require a change in the way this topic is addressed at the university level and beyond. It seems interesting to switch from the current traditional teaching, using traditional resources such as hard copy textbooks, printed materials, and Power Point presentations, to a new and more sophisticated one, involving OER. The creation of open courses in interested

si "Trajtimi i shkarkimeve të lëngëta" dhe "Simulimi në inxhinierinë kimike". Kërkesat aktuale të tregut lidhur me teknologjitë e trajtimit të shkarkimeve të lëngëta kërkojnë një ndryshim në mënyrën se si kjo temë adresohet në nivelin universitar dhe më tej. Shihet me interes zëvendësimi i sistemit aktual tradicional, i cili përdor burime tradicionale (tekste, materiale të printuara, prezantime në PowerPoint), nga një sistem i ri e më i sofistikuar, që përfshin OER. Krijimi i një kursi të hapur në tematikat me interes, mundësia për leksione të hapura nga ekspertë të fushës mbi metodat moderne instrumentale analitike për analizimin e ujërave dhe/ose mbi zhvillimet e fundit në teknologjitë e trajtimit të shkarkimeve të lëngëta (me theksin tek studimet eksperimentale dhe kompjuterike) shikohen si mënyra efektive për të rritur cilësinë e mësimdhënies. Projekte si "ICT - Networking for Overcoming Technical and Social Barriers in Instrumental Analytical Chemistry education" (NETCHEM) dhe bashkëpunime ndërmjet partnerëve janë mënyra më e mirë për momentin për të lehtësuar zbatimin e teknikave të reja. Veçanërisht e rëndësishme është lidhja e punës eksperimentale me teknikat e simulimit kompjuterik. Përdorimi i OER-it në këtë këndvështrim ka të bëjë me ndërlidhjen e një sërë instrumentesh laboratorike me kompjuterë, të cilët, nga ana e vet, mund të lidhen me njëri-tjetrin në një network lokal. Nga këndvështrimi i një institucioni, eksperimentet në largësi nënkuptojnë përdorim më të mirë të pajisjeve dhe nevojë më të pakët për të realizuar seanca laboratorike të mbikëqyrura. Gjithashtu, hap mundësinë e ndarjes së pajisjeve të shtrenjta për mësimdhënie dhe kërkime. Manualet e laboratorit mund të përmirësohen lehtësisht, mësimi në grup lehtësohet dhe puna e studentëve mund të verifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pavarësisht aspekteve pozitive, funksionimi i mirë i sistemit kërkon që të merren në konsideratë edhe disa aspekte teknike të rëndësishme. Kjo do të thotë se është thelbësore bashkëpunimi në shkallë të gjerë ndërmjet specialistëve.

Fjalë çelës: *Burime të Hapura të Mësimdhënies (OER), përmirësimi i procesit të mësimdhënies, eksperimente laboratorike, simulim kompjuterik, eksperimente në largësi, NETCHEM.*

subjects; the access to open lectures, by experts in the field, on up-to-date instrumental analytic methods for water analysis and/or on recent trends on wastewater treatment technologies (with the emphasis on experimental and computational studies) are seen as effective ways to increase the teaching quality. The "ICT Networking for Overcoming Technical and Social Barriers in Instrumental Analytical Chemistry education" (NETCHEM) project and cooperation between partners are currently the best way to facilitate their implementation. The connection of experimental work with computational simulation techniques is particularly important. The use of the OER in this context relates to interfacing a series of different laboratory instruments to computers, which, in turn, can be connected to a local area network. From an institution's perspective, remote experiments mean better use and sharing of equipment and less need to provide supervised laboratory sessions. It also opens the possibility of sharing expensive equipment for both teaching and research. The laboratory manuals can be readily upgraded, the team teaching can be facilitated, and the student work can be directly verified. Despite the positive sides, the system's good functioning requires some very important technical aspects to be considered. This means that the wide scale collaboration between specialists is crucial.

Keywords: *Open Educational Resources, teaching process improvement, laboratory experiments, computational simulation, remote access, NETCHEM.*

**Shaniko Allajbeu[1,2], Pranvera Lazo[2], Flora Qarri[3]**
*[1]Albanian Young Academy. [2]Department of Chemistry of University of Tirana, Tirana. [3]Department of Chemistry of University "Ismail Qemali" of Vlora*

## Biomonitoring a new approach to integrated assessment of the scale of pollution in Albania

Nowadays, clean air is an essential component for our health and the surrounding environment. However, the breathing air has deteriorated considerably since the industrial revolution - mainly as a result of an-

**Shaniko Allajbeu[1,2], Pranvera Lazo[2], Flora Qarri[3]**
*[1]Akademia e të Rinjve, [2]departamenti i kimisë i Universitetit të Tiranës, [3]departamenti i kimisë i Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali"*

## Biomonitorimi – një qasje e re për vlerësimin e integruar të shkallës së ndotjes në Shqipëri

Cilësia e ajrit është thelbësore për shëndetin tonë dhe atë të mjedisit. Që nga revolucioni industrial, cilësia e ajrit që thithim ka rënë në mënyrë të konsiderueshme kryesisht për shkak të aktivitetit njerëzor. Në vendin tonë nuk ka ekzistuar një rrjet monitorimi periodik i ndryshimit të kushteve mjedisore në hapësirë e në kohë. Një numër i madh kërkimesh mbi monitorimin e faktorëve ndotës mjedisorë si dhe shkallës së impaktit të tyre zhvillohen shpesh nga institucione e agjenci mjedisore lokale e kombëtare, por parametrat e marrë në studim janë të kufizuar. Nga ana tjetër, analizimi i të dhënave të marra dhe interpretimi i tyre realizohet shpesh në forma rastësore e të përgjithshme. Një vlerësim i integruar pas marrjes së të dhënave si dhe paraqitja pamore në një formë të përshtatshme dhe të kuptueshme rrit mundësinë për të njohur më mirë burimet e ndotjes si dhe shkallën e impaktit të tyre në mjedis. Në studimin tonë është bërë një harmonizim i njohurive njerëzore me kompjuterizimin e procesit nëpërmjet përpunimit statistikor të të dhënave eksperimentale, përdorimit të teste të ndryshme statistikore, aplikimit të disa indekseve që karakterizojnë nivelet e ndotjes dhe përdorimit të teknikës GIS. Ndërthurja e disiplinave të ndryshme shkencore ka bërë të mundur thjeshtimin e procedurave eksperimentale dhe minimizimin e kostos së studimit në shkallë kombëtare e më gjerë. Kështu, përdorimi i myshkut (Hypnum cupressiforme dhe Pseudoscleropodium purum) si bioindikator i metaleve të rënda bën të mundur realizimin e studimit të depozitimit ajror në kohë dhe në hapësirë në shkallë të gjerë. Studimi u realizua gjatë vitit 2010, ku u përfshinë 64 stacione të shpërndara mbi territorin e Shqipërisë. Analizat për përcaktimin e elementeve gjurmë në këto mostra u kryen me metodën e spektroskopisë së emisionit atomik me plazmë të çiftuar me induksion (ICP-AES) pranë Institute of Chemistry, Faculty of Science, Sts. Cyril and Methodius University, Shkup, Maqedoni, dhe me metodën me aktivizim neutronik (NAA) pranë Joint Institute for Nuclear Research (JINR) në Dubna, Rusi. Me anë të përpunimit statistikor të rezultateve, llogaritjes së faktorit të ndotjes dhe indeksit potencial ekologjik, u arrit një skemë që tregon një informacion përfaqësues dhe vlerësues mbi nivelin e ndotjes në vendin tonë.

thropogenic activities. In our country there is no presence of any environmental monitoring system to observe systematically the change of environmental conditions in time and space. The research to monitor the environmental pollutants and their impact usually is done by National environmental agencies but in these cases the parameters under study are limited. On the other hand, the analysis of the obtained data and their interpretation are expressed randomly and in the general forms. After sampling, sorting and identification of data, an efficient and adequate analyzing would be to take in consideration an integrated assessment of pollution points and the level of their impact on the environment. In our study, the level of pollution represented by technical GIS is obvious. The study includes a combination of several elements such as, general scientific knowledge with statistical data, where we apply the analysis of experimental data using different statistical methods and some indices. Using a combination of knowledge from different discipline in this case, has made the experimental procedure simpler and has also decreased the general study cost. Thus, the uses of moss (*Hypnum cupressiforme* and *Pseudoscleropodium purum*) as a bioindicator of heavy metals make it possible to carry out the study of air deposition in large-scale in time and space. The study was carried out during 2010 and 64 stations were included in monitoring, distributed in the entire territory of Albania. The analysis for determination of trace elements in these samples was performed by *inductively coupled plasma-atomic emission spectrometry* (ICP-AES) *at the Institute of Chemistry, Faculty of Science, Sts. Cyril and Methodius University, Skopje, Macedonia*, and with the *Neutron Activation Analysis* (NAA) at the *Joint Institute for Nuclear Research* (JINR) in Dubna, Russia. Through the statistical processing of the results and the calculation of contamination factor and potential ecological index, was developed a scheme showing a representative estimate of the level of pollution in our country.

Also, drawing maps by GIS technique made it possible to study the spatial distribution of these elements more clearly, and it was determined that the areas with higher pollution from the atmospheric deposition are the mineral areas and the industrial zone of Elbasan.

Keywords: *Atmospheric Deposition, Biomonitoring, Integrated Assessment, Statistical Processing, Contamination Factors, GIS*

Gjithashtu krijimi i hartave me teknikën GIS bëri të mundur studimin më të qartë të shpërndarjes hapësinore të këtyre elementeve, ku u përcaktua se zonat me ndotje më të lartë nga depozitimet atmosferike janë zonat mineralmbajtëse dhe zona industriale e Elbasanit.

Fjalë çelës: *depozitim atmosferik, biomonitorim, vlerësim i integruar, përpunim statistikor, faktorët e ndotjes, GIS.*

**Teuta Toska**
*Akademia e të Rinjve, departamenti i gjuhësisë i Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan*

**Për metodologjinë e kërkimit shkencor në gjuhësinë shqiptare pas viteve '90**

Dikur kërkimi shkencor në gjuhësi ishte pjesë e instituteve kërkimore dhe studiuesi i ri ndiqte modelin e drejtuesit të vet shkencor; sot ai është pjesë e kurrikulës universitare dhe metodologjia e kërkimit shkencor është një kurs i pranishëm që në ciklin e parë të studimeve. Por cikli doktoral, si kulmi dhe sinteza e kërkimit të mirëfilltë shkencor mund të pasqyrojë posaçërisht ndryshimet e qenësishme që ka pësuar metodologjia e kërkimit në gjuhësinë shqiptare. Kjo kumtesë mbështetet në një studim sasior të të dhënave të marra nga një numër i konsiderueshëm doktoratash në gjuhësi, pas viteve '90. I përqendruar në mënyrë të veçantë në metodologjinë e përdorur nga studiuesit e rinj, do të përpiqemi të paraqesim një panoramë me të dhëna numerike në lidhje me: praninë ose jo të një çështjeje për metodën e përdorur në kërkimin doktoral, përcaktimin e llojit të metodës së përdorur, kushtëzimin e rezultateve prej përdorimit të metodës, modelet e metodave të përdorura, vetëdijen mbi metodën tradicionale apo metodat e reja në dritën e zhvillimeve të fundit në gjuhësinë botërore, por edhe në teknologji etj. Studimi do të vlerësojë këto të dhëna edhe në mënyrë cilësore, për të arritur në përfundime që lidhen me gjendjen e studimeve gjuhësore në Shqipëri, përqafimin e metodave të reja, prirjen e këtyre studimeve në këto vitet e fundit.

Fjalë çelës: *gjuhësi, kurrikulë universitare, metodologji e kërkimit, studim sasior, doktoratë*

**Teuta Toska**
*Albanian Young Academy, Department of Language of University "Aleksander Xhuvani", Elbasan*

### About the methodology of the scientific research in Albanian linguistics after the 1990's

Once the scientific research in linguistics was part of the research institutes and the new researcher followed the model of his own scientific mentor; nowadays it is part of the university curriculum, and the methodology of scientific research is a course which is present since the first cycle of studies. But the doctoral cycle, as the peak and the synthesis of the authentic scientific research may in particular reflect the inherent changes that the research methodology has undergone in Albanian linguistics. This paper relies on the quantitative research into a considerable number of doctoral theses in linguistics after the 1990's. Particularly focused on the methodology used by young researchers, we will try to present an overview based on quantitative data, relating to: the presence or not of a case for the method used in doctoral research, the determination of the type of the method used, the conditioning of the results from the use of the method, the patterns of the methods used, the awareness of the traditional method or the new methods in the light of the latest developments in world linguistics, and also, in technology, etc. This research is going to evaluate this data in the qualitative way, to reach conclusions related with the state of linguistic research in Albania, the embracing of new methods and the tendency of these studies in recent years.

Keywords: *linguistics, university curricula, methodology of research, quantitative research, doctoral research*

**Valbona Sota[1], Efigjeni Kongjika[2]**
*[1]Akademia e të Rinjve, departamenti i bioteknologjisë i Universitetit të Tiranës, [2]seksioni i shkencave natyrore dhe teknike i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë*

## Optimizimi i metodave të mikroshumimit dhe të konservimit *in vitro* të specieve frutore me rëndësi ekonomike

Larmia e karaktereve orografike e klimatike i bëjnë trevat shqiptare në Ballkan një nga vatrat më të përqendruara dhe më të pasura me specie autoktone të vlefshme. Speciet spontane, paraardhëse të drurëve frutorë të kultivuar përfaqësojnë një burim variabiliteti gjenetik me rëndësi në programet e përmirësimit gjenetik dhe të kultivimit. Impakti shoqëror-ekonomik dhe mjedisor përligj nevojën e vlerësimit dhe të ruajtjes së këtyre burimeve gjenetike. Në këtë punim paraqiten mundësitë potenciale të metodave të kulturës indore për përdorimin, mikroshumimin dhe konservimin e aksesioneve të specieve endemike e të rrezikuara për zhdukje, të specieve frutore autoktone dhe të disa kultivarëve tregtarë. Përparësitë e këtyre metodave bashkëkohore në krahasim me ato konvencionale, të përdorura deri tani në vend, lidhen me (i) ruajtjen e specieve që shumohen me vështirësi me farë; (ii) mbajtjen e një numri të vogël individësh në pak sipërfaqe, duke ruajtur potencialin rigjenerues në çdo kohë të vitit (iii) ruajtjen e qëndrueshmërisë gjenetike me përdorim të kulturës së meristemës, majave e embrioneve (iv) ruajtjen e specieve endemike dhe të kërcënuara (v) shkëmbimin e materialit gjenetik të painfektuar pa nevojën e karantinës. Për këto qëllime, kryesisht përdoren metodat e organogjenezës direkte të mikroshumimit, duke eliminuar atë indirekte dhe kallusogjenezën me mundësi potenciale të shfaqjes së variacioneve somaklonale. Bimët e shëndetësuara, speciet aromatike mjekësore të shtuara në një kohë të shkurtër, varietetet elitare të kultivuara etj. janë produkte bioteknologjike të përftuara me metoda të ndryshme, si: kultura e meristemës, mikroshumimi në terren të ngurtë dhe me shtresë të dyfishtë, kultura embrionale, embriogjeneza somatike etj. Një objektiv tjetër është dhe konservimi i gjermoplazmës së specieve endemike, të rralla dhe të rrezikuara për zhdukje, e cila duhet ruajtur si pasuri identifikuese shqiptare. Janë eksperimentuar disa metoda të konservimit *in vitro* si metodat e rritjes minimale (temperaturë e ulët

**Valbona Sota[1], Efigjeni Kongjika[2]**
*[1]Albanian Young Academy. Department of Biotechnology of University of Tirana. [2]Section of Natural Technical Sciences of Academy of Sciences of Albania*

### Optimisation of micropropagation and *in vitro* conservation methods of fruit tree species economically important

The variety of orographic and climatic characters make the Albanian land one of the most concentrated and the richest areas of native autochthonous species in the Balkans. The spontaneous plant species, progenitor of cultivated fruit trees, represent an important source of genetic variability in genetic improvement and cultivation programmes. The social-economic and environmental impact justifies the need for evaluation and conservation of these genetic resources. This paper presents the potential possibilities of plant cell and tissue culture methods for the use, the micropropagation and the conservation of endemic, rare and endangered accessions, of autochthonous fruit trees and some commercial cultivars. The advantages of these contemporary methods in comparison with the traditional ones used in Albania to this date, are related with: (i) the conservation of those species which are hardly propagated by seed; (ii) the maintenance of a small number of plantlets in a small surface conserving their regeneration potential in every time of the year; (iii) the maintenance of genetic stability using meristem, shoot or embryo culture; (iv) the preservation of endemic and endangered species; (v) the exchange of virus-free genetic material without the need of quarantine. The methods of direct organogenesis are mostly used for these purposes, eliminating the indirect ones which include callusogenesis with potential for the occurrence of somaclonal variations. Virus-free plant material, aromatic medicinal plants multiplied in high quantity for a short time, elite varieties cultivated and conserved for different purposes etc. are biotechnological products obtained by different methods such as: meristem culture, micropropagation in semisolid and double-phase media, embryo culture, somatic embryogenesis etc. Another objective is the conservation of endemic, rare and endangered germplasm, which needs to be protected as Albanian identity property. Different methods of *in vitro* conservation are experimented. The methods of minimal growth are used separately or in combinations to slow down the growth rate of the stored explants, such

dhe reduktim i ndriçimit; modifikim i terrenit ushqyes me mungesë fitohormonesh dhe reduktim të lëndëve inorganike ose të karbohidrateve, inkapsulimi). Metoda e inkapsulim-dehidratimit është përdorur për të testuar fazat parapërgatitore për kriokonservimin (ruajtjen afatgjatë) e eksplanteve. Konservimi i gjermoplazmës përballet me sfidat e zgjedhjes së aksesioneve të painfektuara nga patogjenët dhe ruajtjes së niveleve natyrale të diversitetit gjenetik. Këto studime shërbejnë për ngritjen e bankave gjenetike *in vitro* të aksesioneve bimore në Shqipëri.

Fjalët çelës: *mikroshumim, shëndetësim, metoda të rritjes minimale, kriokonservim, hormone bimore*

**Xhaklina Cani[1,2], Ilirjan Malollari[2], Ismet Beqiraj[2]**
*[1]Akademia e të Rinjve, [2]departamenti i kimisë industriale i Universitetit të Tiranës*

### Praktika metodologjike për karakterizimin e naftave bruto të vendit tonë dhe zbatime

Distilimi i naftës bruto përfaqëson një rast të veçantë të distilimit të vazhduar shumëfazor me shumë përbërës. Nafta bruto është një përzierje komplekse e komponimeve organike, e cila përfshin komponimet alifatike, aromatike dhe heterociklike. Para përpunimit në rafineri është e rëndësishme të njihet përbërja e saj. Përveç karakterizimit të naftës bruto bazuar në analizat fiziko-kimike dhe klasat e hidrokarbureve, një nga indikatorët që përdoret në karakterizim është edhe "faktori i karakterizimit". Në bazë të këtij faktori jemi në gjendje të përcaktojmë tipin e naftës bruto të përdorur.

Në studim paraqitet një praktikë metodologjike e karakterizimit, duke përdorur programin e simulimit Aspen HYSYS. Ky program është zgjidhja më e mirë e modelimit të procesit, që ofron përfitime të mëdha ekonomike gjatë gjithë ciklit jetësor të procesit inxhinierik, duke dhënë një kombinim unik të teknologjisë inovative dhe të dobishme. Përdorimi i këtij programi paraqet një metodë të re të karakterizimit të naftave bruto në Shqipëri. Deri tani klasifikimi dhe karakterizimi është realizuar duke u bazuar në të dhënat eksperimentale të mostrave të studiuara. Me anë të kësaj metode arrihen të përcaktohen nënproduktet që përftohen

as, the elimination of PGRs in nutrient media, the diminution of sucrose amount in the basal media, the incubation in low temperatures and/or darkness, the encapsulation etc. The technique of encapsulation – dehydration - is used for testing the preparatory phases of the cryoconservation (long term preservation). The germplasm preservation faces the challenges for selection of virus-free accessions and conservation of natural genetic diversity levels. These studies serve for the establishment of *in vitro* genetic banks for plant accessions in Albania.

Keywords: *micropropagation, sanitation, minimal growth methods, cryoconservation, plant hormones*

**Xhaklina Cani[1,2], Ilirjan Malollari[2], Ismet Beqiraj[2]**
*[1]Albanian Young Academy. [2]Department of Industrial Chemistry of University of Tirana, Albania*

**Methodological practice of crude oil characterization in our country and applications**

Crude oil distillation represents a special case of multicomponent and multistage continuous distillation. The crude oil is a complex mixture of organic compounds including aliphatic, aromatic and heterocyclic elements. It is important to recognize the crude oil composition before it is processed in the refinery. Beyond the characterization of crude oil based on physic-chemical analysis and the hydrocarbon classification, one of the leading indicators used for its description is the “characterization factor”. Based on this factor, we are able to identify the type of crude oil to be used.

This study presents a methodological practice for characterization by using the Aspen Hysys simulation program. This program is the best solution for establishing the process and offers great economic benefits during the development of the engineering process, delivering a unique combination of innovative and useful technology. This program represents a new method of characterizing crude oil in Albania. Until now, the classification and characterization of our country’s crude oil samples has

nga përpunimi i një nafte bruto të caktuar, të cilat përgjithësisht karakterizohen në termat e pseudo – komponentëve. Gjithashtu ky program mundëson jo vetëm përcaktimin e karakteristikave të tyre, por edhe përcaktimin e klasave të hidrokarbureve të mostrave të studiuara nga vendburime të ndryshme në Shqipëri. Kjo metodë karakterizimi është hapi i parë për simulimin e mëtejshëm të skemave të ndryshme të përpunimit të naftave bruto.

Fjalë çelës: *karakterizim, naftë bruto, Aspen HYSYS, simulim*

been gathered through experimental data. By using this method, we are able to determine the by-products that can be obtained when processing a certain kind of crude oil, which are generally characterized in terms of a pseudo component. In addition, with this program, they are defined not only by their characteristic, but also by the hydrocarbon classes of the samples studied from different oilfields in Albania. This characterization method is the first step of different crude oil processing schemes.

Keywords: *Characterization, Crude oil, Aspen Hysys, Simulation*

## SHËNIME / NOTES

AKADEMIA E TË RINJVE, 2017

Konferenca e Parë Shkencore e Kërkuesve të Rinj

4 dhjetor 2017 | Tiranë

---

Albanian Young Academy, 2017

1St Scientific Conference Of The Young Researchers

4 dhjetor 2017 | Tirana